

“...Tragjikët qenë përpjekur t’i shkruanin por s’kishin mundur, ndaj në pamundësi të kësaj, si një zgjidhje të përkohshme kishin lënë ligjin e tri uniteteve. Dantja i qe afruar më shumë kurse Shekspiri më pas i qe larguar përsëri. Shekspiri kishte bërë zbulesa të tjera. Zot, ky laborator ishte me mundësi të pafundme dhe ty të vinte të thërrisje si i dehur: unë jam i lumtur, unë kuptoj...” - Kadare

Kadare dhe të tjerët: në *gostinë* e shenjtë dhe mistike të krijimit letrar

nga Matteo Mandalà



Portreti nga Ina Lajthia

(fq. 2-4)

**“LEGJENDA E VETMISË”
E RIDVAN DIBRËS**

EVELYNE NOYAGE, ME
ROMANIN SHQIPTAR, PËR
HERË TË DYTË NË LISTËN
E NGUSHTË PËR ÇMIMIN E
PËRKTHIMIT NË FRANCË

(fq. 5)



Intervistë me akademikun nga Kosova për jetën dhe
studimet gjuhësore

REXHEP ISMAJLI

**E tërë jeta jonë kulturore është zhvilluar
në një kundërvënie të nëntëshme**

Intervistoi: Violeta Murati

(fq. 6)



“DITAR I SHKURTËR KUFIJSH”

ROMANI I GAZMEND
KAPLLANIT FRYMËZON
KOMPOZITOREN E
FAMSHME BRITANIKE

(fq. 13)

Romani i Virgjil Muçit, mbi një mjedis ku është
e vështirë ta ruash arsyen, kur bota humbet
fillin — **Nga Ledia Dushi**

(fq. 12)

‘Lulet e egra’ të Majlinda Ramës, zëri
që presim! — **Nga Kim Mehmeti**

(fq. 10)

**GJENITË
ME
FYTYRË
ËNGJËLLI**

nga Michèle Gazier



Agron Gashi
NË KOSOVË DOLI
NUMRI I RI I
REVISTËS LETRARE
“JETA E RE”



**ËNDRRA
E VDEKJES
SIME”**

Gentur Lleshi

BIBLIOTEKË

**ERDHËM
NGA UJI**

**Lediona
Braho**



“...Tragjikët qenë përpjekur t’i shkrinin por s’kishin mundur, ndaj në pamundësi të kësaj, si një zgjidhje të përkohshme kishin lënë ligjin e tri uniteteve. Dantja i qe afruar më shumë kurse Shekspiri më pas i qe larguar përsëri. Shekspiri kishte bërë zbulesa të tjera. Zot, ky laborator ishte me mundësi të pafundme dhe ty të vinte të thërrisje si i dehur: unë jam i lumtur, unë kuptoj...” - Kadare

Kadare dhe të tjerët: në *gostinë* e shenjtë dhe mistike të krijimit letrar

Shpesh shkrimtarët e mëdhenj u kanë dhuruar interpretime të jashtëzakonshme veprave të kolegëve të tyre: Elioti që lexon Euripidin, Danten dhe Shekspirin, apo Kafka që përzgjedh Floberin, Pound që lartëson Joyce-n dhe ky i fundit që nxit mikun e tij italian Italo Svevo-n, për t’u përmbajtur në shembuj të epokës moderne

Nga Matteo Mandalà

1.

Ky vëllim përmbledh tri ese të famshme të Ismail Kadaresë që u kushtohen po aq kryeveprave të pavdekshme të letërsisë së të gjitha epokave, nga ajo antike (Eskili), në atë mesjetare (Dante), deri te ajo moderne (Shekspiri). Në këtë antologji, për mendimin tim, mund të përfshiheshin edhe të tjera tekste, si për shembull shkrimet për bashkatdhetarët e tij të ndritur, nga De Rada te Lasgush Poradeci, te Migjeni, apo disa faqe kushtuar Homerit, Ovidit, Servantesit, Gogolit, Pushkinit, Kafkës, Folknerit etj., të shpërndara nëpër korpusin e veprave “eseistike” të autorit që tek e fundit dëshmojnë ballafaqimin e tij intim me pararendësit në kërkim të përsosmërisë artistike. Gjithsesi, arsyeja kryesore e përfshirjes së vetëm këtyre tri eseve kushtuar

tragjediave të Eskilit, *Komedisë Hyjnore* dhe *Hamletit*, nuk është diktuar nga zgjedhje apo interesa editoriale, por nga dëshira për të nderuar qëndrimin kritik dhe idetë e vetë autorit: liria e përgatitësit të vëllimit për ta “zgjeruar” vëllimin i ka lënë vendin – sikurse është e natyrshme të bëhet, të paktën në këtë rrethanë – vullnetit të autorit.

Kadare, në fakt, në një intervistë që i ka dhënë Jorina Shkreta-Kryeziut, jo vetëm që deklaroi hapur se “janë tri ese [...] më të rëndësishmet: *Eskili*, *ky humbës i madh*, *Hamleti*, *princ i vështirë* dhe *Dantja i pashmangshëm*”, por, duke u rrekur të shpjegojë arsyet e kësaj zgjedhjeje, na ofron njëherazi disa të dhëna paraprake me interes kritik që do t’i rimarrim shkurt më poshtë, sepse na ndihmojnë të krijojmë një vizion më organik rreth poetikës së autorit të tij. Kjo jo vetëm

na detyron të pranojmë se para këtyre të dhënave do të ishte e pavend, madje arbitrare, të ndiqej një tjetër rrugë editoriale, por na bën gjithashtu të vëmë në dukje vlerën e vëzhgimeve të Floresha Dados me të cilat pajtohemi plotësisht edhe nga këndvështrimi metodologjik, ku studiuesja e nderuar thekson rolin qendror të eseistikës në lëmin e studimeve kadareane, duke e konsideruar me të drejtë këtë si një gjini strategjike, me kusht që të zhvishet nga përdorimet dhe shpërdorimet e sofizmit *post hoc, propter hoc*, për t’ia lënë vendin vetëm atyre interpretimeve hermeneutike që mund të shpjegojnë natyrën komplekse të veprës së njërit prej shkrimtarëve më të mëdhenj bashkëkohorë.

2.

Vlera e “leximit” të librave të mirë nuk mund të thjeshtëzohet në konceptin banal të metaforës bajate të *dialogut didaktik*, të përdorur nga John Ruskin, koncept me të cilin debatoi Prusti duke u mbështetur te Kartezi. Autori i *Recherche* nuk pajtohej me idenë që leximi të ishte “një bashkëbisedim me njerëzit më të nderuar të shekujve të shkuar që kanë qenë shkrimtarët”, pasi kjo do të thoshte rrafshim i forcës frymëzuese të veprës, pra cenim i asaj aftësie subjektive të lexuesit që i “përpunon” pareshtur veprat që lexon, në funksion të aftësisë krijuese vetjake. Për këtë arsye Prusti mendonte se “Leximi, ndryshe nga bashkëbisedimi, për secilin prej nesh qëndron në njohjen e mendimit të tjetrit, duke mbetur gjithnjë vetëm, pra duke gëzuar forcën intelektuale që na jep vetmia dhe që biseda e prish, duke mbetur të frymëzuar, me shpirtin dhe mendjen në aktivitet të plotë”. Do nënvizuar këtu se edhe Kadare do të ndalet në të njëjtat koncepte të trajtuara prej Prustit. Do ta bëjë thuajse në të gjitha shkrimet e tij me gjykime letrare dhe do ta përsërisë çdo herë që do të ndiejë nevojën për të theksuar karakterin unik të natyrës vetmitare ku mbështetet si shkrimi ashtu dhe leximi, për të theksuar forcën intelektuale që ngjall frymëzimi, deri edhe për të pohuar të drejtën e rastësisë së zgjedhjes së librit që lexohet, pa harruar të drejtën e pranimit të sfidës së madhe dialektike me të cilën të përball vepra letrare “duke të ftuar” të zhvillosh këndvështrimin *tënd* dhe të përmbledhësh idetë *e tua*. Këndvështrim dhe ide të cilat, të përpunuara nën prizmin e botëkuptimit vetjak, jo rastësisht i gjejmë të ndërputhura në veprat në prozë që i japin poetikës kadareane vulën e patjetërsueshme dhe tipike të letërsisë së madhe.

Për “leximet autoriale” të Kadaresë nuk është shkruar shumë, ndoshta sepse – siç u tha – shumë prej tyre janë shpërndarë nëpër vepra të ndryshme, ku shpesh nuk bien fort në sy. Kjo nuk ka penguar, gjithsesi, që vëzhgimet e thukëta të disa studiuesve të shquar nga vende të ndryshme të mundësonin ndër vite përvijimin e një profili të qartë të kontributit kritik që ka dhënë autori ynë në zbërthimin e disa kryeveprave botërore siç janë ato të Eskilit, Dantes, Shekspirin, por edhe të klasikëve të tjerë si Homeri, Servantesi apo Kafka. Këta studiues kanë vënë në dukje së kombinimi i dhuntisë narrative me intuitën e një lexuesi të jashtëzakonshëm siç është Kadare nga njëra anë na ndihmon të zbulojmë disa aspekte të fshehta të kryeveprave letrare, nga ana tjetër, duke rrafshuar dallimet kohore dhe hapësinore mes veprave dhe autorëve të tyre, na fton edhe ne, lexuesit e thjeshtë, në *gostinë* e shenjtë dhe mistike të krijimit letrar. Nga ky këndvështrim për specialistët e fushës “leximet autoriale” të Kadaresë nuk vijnë si një risi. Shpesh shkrimtarët e mëdhenj u kanë dhuruar interpretime të jashtëzakonshme veprave të kolegëve të tyre: Elioti që lexon Euripidin, Danten dhe Shekspirin, apo Kafka që përzgjedh Floberin, Pound që lartëson Joyce-n dhe ky i fundit që nxit mikun e tij italian Italo Svevo-n, për t’u përmbajtur në shembuj të epokës moderne, janë vetëm episode të famshme të cilat, megjithëse





të shkëputura njëra prej tjetrës, përvijojnë përmasën e përafrisë së pashpjegueshme të ideve që tërheqin misionarët e letërsisë duke i shndërruar njërin në bashkëbiseduesin e parapëlqyer të tjetrit. Në vizionin madhështor që Kadare ka përjetësuar metaforikisht te novela *Ëndërr mashtruese*, parafrazohet, ndoshta pavetëdijshëm, parimi spekulativ mbi të cilin bazohet sistemi filozofik i Hegelit: ashtu si në progresin e njohjes shkencore vlejnë konceptet dhe jo emrat e tyre që i kanë formuluar, ashtu dhe zbulimet në letërsi u përkasin veprave dhe jo autorëve të tyre. Gjithashtu, nuk mendoj se zbuloj ndonjë të re nëse shtoj se në këtë ndërtekstorësi të shoqishoqme, në këtë lojë të pafund gjurmësh që veprat letrare ndërtojnë midis tyre, në këtë kuvend gjithëpërfshirës mes artistësh të të gjitha kohëve, qëndron sekreti i ruajtjes së krijimtarisë letrare, të përmasës së saj kontradiktore johistorike dhe të perceptimit subjektiv që ndjekësit e saj vërejnë në forcën thujtë metafizike të shkrimit.

3.

Qëllimi kryesor i këtyre faqeve përjashton mundësinë e ndërmarrjes së një hetimi të dyfishtë: nga njëra anë të një shqyrtimi shterues të stileve të shumta që Kadare thotë se i ka rikuperuar nga leximet *vetjake* të veprave të Eskilit, Dantes, Shekspir dhe kolegëve të tij të shumtë, nga ana tjetër, të vendosjes së tyre përgjatë lakores së ndjekur nga poetika e tij me se pesëdhjetëvjeçare. Të gjithë lexojmë të njëjtat faqe, por nuk i “asimilojmë” në të njëjtën mënyrë dhe, për pasojë, nuk krijojmë të njëjtin vizion, siç mund të

bëjnë në fakt vetëm ata që bashkëndajnë misterin e krijimit letrar, perceptojnë sekretin dhe ambiguitetin e tij, njohin zhvillimin e dhimbshëm, dramat dhe madhështinë e fjalës së shkruar artistike, kodet sekrete që e ngrenë, – siç vëren me të drejtë Kadare në lidhje me “gjuhën italiane” të Dantes, – nga kusht komunikimi të zakonshëm në një mjet të fuqishëm përmes të cilit shfaqet sublimja, hyjnorja. Prandaj shkrimtarët janë të veçantë, të gjithë pa përjashtim: mënyra e tyre e “leximit” të historisë së letërsisë nuk është e zakonshme dhe sidomos nuk përkon me po atë kënaqësi leximi që bashkon lexuesit e tjerë, të zakonshëm apo me përvojë qofshin. Shkrimtarët mësojnë nga kolegët e tyre, dhe kur binden se janë gati, përkthejnë në gjuhët e tyre vetjake simbolet universale të letërsisë. I tillë ka qenë edhe rrugëtimi i Kadaresë qysh në moshë të re, qysh kur mbeti i mrekulluar nga leximi i Makbethit dhe nga fantazmat që gjeti aty. Më vonë ato shfaqje joracionale gjetën një shëmbëllim emotiv edhe më të mprehtë, por këtë herë energjia e ndërsyer që buronte nga leximi, hasi në përpjekjen kryeneçe të shkrimtarit për ta shtruar dhe për ta mbrytur atë sipas mënyrës së vet.

Këtë e dëshmon ky fragment i veprës *Pesha e kryqit*, ku Kadare duke folur për periudhën rinore kur sapo kishte filluar të merrej me letërsi, përshkruan “përvojën” e vet si lexues i veçantë dhe ia beson pasionet e veta letrare së njëjtës botë që ushqente vitalitetin e tij krijues:

“Nuk ishin vetëm gjetjet që më gëzonin, më shumë se ato ishte natyrshmëria me të cilat iu ngjiteshin subjekteve. Si një thirrje instinktive ato ndillnin format, dhe format shfaqeshin qysh në thirrjen e parë.

Kishte edhe raste që më mundonin, më ngatërronin, ma bënin mendjen lëmsh, por kjo ishte një torturë e mrekullueshme. Përpiqesha, për shembull, të gjeja një truall të ri, që bashkë me hapësirën të kishte brenda kohën. Tragjikët qenë përpjekur t’i shkrinin por s’kishin mundur, ndaj në pamundësi të kësaj, si një zgjidhje të përkohshme kishin lënë ligjin e tri uniteteve. Dantja i qe afruar më shumë kurse Shekspiri më pas i qe larguar përsëri. Shekspiri kishte bërë zbulesa të tjera. Zot, ky laborator ishte me mundësi të pafundme dhe ty të vinte të thërrisje si i dehur: unë jam i lumtur, unë kuptoj...”

4.

Ky “rrëfim” është i rëndësishëm për disa arsye që po i renditim më poshtë: arsyeja e parë është e natyrës historike, pasi ka të bëjë me shqetësimet, jo medoemos intime, të gjysmës së dytë të viteve ’60, mu në kulmin e krizës që fillimisht përfshiu Kadarenë pas ndalimit të *Përbindëshit*, ndërsa fill më pas i hapi rrugën ringjalljes së tij intelektuale me përpunimin e romaneve të mëdha që shënuan kufirin pa kthim të vizionit të tij të ri poetik. Qysh atëherë – dhe është kjo arsyeja e dytë, do të thosha, e rrafshit estetik – tragjikët grekë me Eskilin në krye, pastaj Dante i ndjekur nga Shekspiri, u bënë frymëzuesit kryesorë të procesit krijues që do të ripërtërijë laboratorin e shkrimtarit. Aty do të ngjizen tekstet komplekse të romaneve kryesore, të gjithë pjella të një mendjeje përpunuese që prodhonte pa pushim forma, struktura, modele duke i shkëputur nga mishi i vet. Pa iu referuar këtyre tri majave të letërsisë së madhe botërore, nuk kuptohet mrekullia tërheqëse dhe konkretësia stilistike, veçantia gjuhësore e mendimit dhe përmasa ontologjike e realitetit që do ta veshin fjalën estetike të Kadaresë me një forcë narrative unike dhe të patjetërsueshme.

5.

Një arsye tjetër që meriton të merret në konsideratë është ajo që ka të bëjë me botimin, pra me aspektin filologjik. Pikërisht kjo arsye përligj edhe më mirë zgjedhjen e përfshirjes në këtë vëllim të vetëm tri eseve në fjalë. Me shumë gjasa shkrimet e tjera do të na e kishin larguar vëmendjen nga ndikimi që ushtruan mbi prodhimin letrar të Kadaresë autorë si Eskili, Dante dhe Shekspiri në momentet e veçanta kur esetë përkatëse u konceptuan dhe u botuan, çka do të ndryshonte ndjeshëm perspektivën kritike mbi veprat e shkruara përgjatë gjysmës së shekullit që na ndan nga viti 1965. Në fund të fundit, nëse Kadare e ka ndërjetë nevojshme t’ia dorëzojë shkrimit vlerësimet për veprat që kanë ndikuar më tepër në formimin e tij, jo vetëm jemi të detyruar të ndjekim projektin e tij spekulativ, por dhe ta dekodifikojmë atë në dritën e rrugëtimit të artit të tij. Vetëm duke i lexuar veprat sipas kriterave sinoptike mund të rrokim plotësisht simbiozën e ndërtekstorësisë për të cilën flasin Bachtin dhe Kristeva: edhe tekstet kanë një histori marrëdhëniesh mes tyre, që duhet respektuar në mënyrën më absolute. Për pasojë, nga këndvështrimi i historisë së shkrimit të eseve do thënë se ato u përkasin periudhave të ndryshme, pra pasqyrojnë një prirje shpirtërore të veçantë të autorit në çastin kur ka vendosur t’i shkruajë ato.

Shkrimi i esesë për tragjeditë e Eskilit, për shembull, i përket vitit 1985; u botua për herë të parë si hyrje e vëllimit të tragjeditë që Kadare i përktheu vetë në shqipe, ashtu siç kishte bërë Pier Paolo Pasolini me italishten. Ndërsa pesë vjet më vonë, në 1990, teksti i esesë u botua si vëllim më vete. Nga viti 1990 deri më sot kanë dalë botime të tjera me variante jo pa rëndësi që kanë meritën të dokumentojnë evolucionin

e mendimit kadarean si dhe punën e pareshtur kritike që i ka lejuar shkrimtarit shqiptar të rishohë fragmentet më të rëndësishme të variantit të parë dhe, ndonjëherë, të bëjë plotësime me vlerë shpjeguese. Ndër to do përmendur leximi kritik i Homerit, me të cilin më 1999 studiuesi francez i historisë greke antike Pierre Carlier ka komentuar shfaqen e parë ekfrastike në mbarë historinë e letërsisë me vargjet e pavdekshme të këngës XVIII të *Iliadës* ku përshkruhet parzmorja e Akilit. Pikërisht te ky interpretim i Carlier Kadare ka gjetur një dëshmi të jashtëzakonshme të ritit të gjakmarrjes, e prej kësaj ka forcuar bindjen se ligjet zakonore shqiptare mund ta kenë prejardhjen nga lashtësia greke.

Ndryshe qëndron puna me dy esetë e tjera, të cilat pavarësisht varianteve tekstore që hasen në botimet e shumta, ruajnë të paprekur të njëjtën arkitekturë, përmbajtje dhe stil, si për të pohuar ndikimin pozitiv të ushtruar nga kushtet e reja politike të Shqipërisë.

6.

Nga këndvështrimi tematologjik gjatë leximit të këtyre eseve bien në sy referimet e vazhdueshme kadareane për raportin e ndërlikuar mes artit dhe realitetit siç na paraqitet ai te veprat e Eskilit, Dantes dhe Shekspirit, duke respektuar kulturat përkatëse, pra “maskën” e tragjedisë antike dhe konceptin trihapsinor të botës tjetër sipas vizionit katolik mesjetar. Për të mos heshtur për temat që e fusin poetikën kadareane në ujërat e realizmit magjik ballkanik, ku bie në sy motivi i kthimit nga bota tjetër (*revenant*) dhe funksioni prej ndërmjetësi me botën e përtejme që i jepet “fantazmës”, metaforë që pasqyron historinë dhe që Kadare e përdor në mënyrën e bashkëbiseduesve të tij të mëdhenj për t’u përballuar me të shkuarën duke i dhënë asaj “rol të rëndësishëm për çuarjen e kumteve nga njëra botë në tjetrën”.

E ç’mund të thuhet për rëndësinë që Kadare i jep cilësisë që bashkon këta të mëdhenj të letërsisë kur krijojnë personazhe që i marrin nga realiteti dhe i plazmojnë në përputhje me parimin sipas të cilit është në tagrin hyjnor të shkrimtarëve të jenë njëkohësisht krijues dhe të krijuar, ta shohin veten si personazhe mes personazheve, fantazma mes fantazmave, duke u shndërruar edhe ata vetë në gjysmë të vdekur a gjysmë të gjallë! Ç’mund të thuhet për kërkimin e pareshtur të temave rituale antropologjike, si gjakmarrja, besa dhe mikpritja, të sanksionuara në Kanunin e Maleve, që Kadare e interpreton si pjesë e një trashëgimie më të vjetër dhe më të gjerë ballkanike që rrjedh nga bota klasike greke e Orestit dhe që u shtri në mbarë Europën, deri në viset e ftohta të Jutlandit të Hamletit!

Lista e temave të zhvendosura apo thjesht të “rigjetura” nga Kadareja mund të zgjatet edhe më tej, duke përfshirë aty atë të “dyzimit”, që u shfaq te



Portreti nga Ina Lajthia



Hamleti në të njëjtën mënyrë si shpikja shekspiriane e “metateatrit” e cila, nga ana e saj, e shtyu autorin tonë të eksperimentonte arkitektura narrative që nuk u përmbaheshin rregullave të realizmit socialist, pa lënë mënjandë reflektimet e thukëta mbi vlerën e gjuhës poetike, duke filluar me italishten e Dantes e cila, *mutatis mutandis*, ka të njëjtën rëndësi që i jepet shqipes së sotme letrare, e cila pikërisht me veprën e Kadaresë ka arritur majat më të larta të shprehjes artistike. Një temë tjetër e rëndësishme e marrë nga leximi kritik i të mëdhenjve të letërsisë është çështja e ndërlikuar e raportit mes kohës dhe hapësirës, çështje që gjen trajtim të gjerë në veprën narrative të Kadaresë, por që shkrimtari shqiptar nuk ngurron ta trajtojë me ton analitik duke ndërfutur në esenë kushtuar Hamletit një analizë të skicuar paraprakisht te *Ftesë në studio* për vargjet e *Iliadës* që rrëfejnë duelin e pavdekshëm mes Hektorit dhe Akilit rrëzë mureve të Trojës: një analizë që duket se zbaton metodën që përdor Zherar Zhënet për veprën e Prustit, të cilin jo më kot Kadare e mban si shkrimtari që ka pështjelluar në mënyrë të ndërgjegjshme rrjedhën kohore të rrëfimit.

7.

Bazuar në gjithë ç’tamë më sipër, është e pamundur të mos ndikohemi nga forca përfshirëse që frymëzon leximi i këtyre eseve, një lexim që mund ta quajmë “autorial” nëse do të mbërrinim ta ndanim nga leximet e tjera, më të thjeshta dhe të zakonshme, më të cilat tashmë jemi mësuar prej konsumit gjithnjë e më të dobët dhe banal të letërsisë së madhe. Në fakt, nëse ia dalim t’i shpëtojmë këtij kurthi, ndoshta edhe ne mund të marrim pjesë në dialogun e heshtur që zhvillohet mes mendjeve të ndritura të letërsisë qysh prej kohëve homerike. E atëherë ndoshta edhe ne si lexues të zakonshëm do të mund të largojmë dyshimet dhe të davaritim mjegullat mistike që fshehin misteret e letërsisë; më në fund edhe ne do të thërrasim të gëzuar: “Unë jam i lumtur, unë kuptoj...”

Hora e Arbëreshëvet, tetor 2017

Përktheu nga italishtja:
Prof. Dr. Blerina Suta



Romani i autorit shqiptar, Ridvan Dibra, “Le petit Bala, Légende de la Solitude” i përkthyer në frëngjisht, për herë të dytë është në listën e ngushtë, me pesë finalistët, për çmimin e përkthimit Pierre-Francois Caille për përkthimin që, jepet në dhjetor të këtij viti në Francë. Romani “Legjenda e vetmisë” është përkthyer në frëngjisht nga Evelyne Noygues dhe është marrë përsipër nga shtëpia botuese “La Ver a Soie”, Paris

“Legjenda e vetmisë” e Ridvan Dibrës Përkthyesja Evelyne Noyage, për herë të dytë në listën e ngushtë për çmimin e përkthimit në Francë

Romani i autorit shqiptar, Ridvan Dibra, “Le petit Bala, Légende de la Solitude” i përkthyer në frëngjisht, për herë të dytë është në listën e ngushtë, me pesë finalistët, për çmimin e përkthimit Pierre-Francois Caille për përkthimin që, jepet në dhjetor të këtij viti në Francë.

Romani “Legjenda e vetmisë” është përkthyer në frëngjisht nga Evelyne Noygues dhe është marrë përsipër nga shtëpia botuese “La Ver a Soie”, Paris.

Ky çmim është themeluar në vitin 1981 që jepet nga Shoqata Franceze e Përkthyesve (SFT) dhe juria përzgjedhjen e përcakton në bazë të pritjes, e vlerësimin bërë nga lexuesi i vendit, në gjuhën e të cilit është përkthyer romani. Përkthimi i “Legjendës së vetmisë” në frëngjisht, siç ka rrëfyer vetë autori, qe një ide dhe projekt i hershëm i përkthyeses Evelyne Noygues, para se Ministria e Kulturës ta shpallte konkursin, dhe të bënte përzgjedhjen e këtij romani për ta mbështetur zyrtarisht, duke nxitur vënien në jetë të këtij projekti.

Për pritjen e këtij romani në Francë, dhe befasinë e selektimit për herë të parë për çmimin e përkthimit, në një intervistë për “ExLibris”, Dibra është shprehur se: “Përtej asaj që unë e kisha imagjinuar. Duke lënë mënjane modestinë e shtirur, më lejoni t’ju them se rreth këtij romani në Francë ka pasur më shumë shënime kritike për pesë-gjashtë muaj sesa në Shqipërinë time për pesë-gjashtë vjet. Gjithashtu, ky roman qe në listën e ngushtë të veprave të përzgjedhura në Francë për çmimin e përkthimit, çka dëshmon përkushtimin e mrekullueshëm të përkthyeses, së cilës

i jam gjithnjë mirënjohës. Dhe mos harroni, në Francë nuk është aspak e lehtë të tërheqësh vëmendjen: aty botohen çdo muaj me qindra e qindra tituj të rinj”.

Në shënime të botuesit francez, për këtë roman thuhet, mes të tjerash: “Duke e marrë temën nga një këngë e vjetër ballkanase, Ridvan Dibra na ofron një roman psikologjik mbi përjashtimin, vetminë dhe hakmarrjen me theksa herë-herë edipianë...” . Për këtë shënim të kritikës franceze, por edhe pyetjes mbi vendin që zë ky roman, vlerësuar nga disa si më i miri në krijimtarinë e tij, shkrimtari është shprehur se: “Edhe në këtë rast, si në shënime të botuesit ashtu dhe në shënime të tjera kritike, “qasja franceze” është mjaft interesante dhe vë re elemente që te ne nuk janë veçuar. Po, janë disa ata që e gjykojnë këtë vepër si romanin tim më të mirë. Edhe pse unë nuk mendoj ashtu. Ndoshta do ta quaja si romanin tim më me fat. Të tjera emocione, ku e ku më të forta, gjatë punës me të, por dhe më pas, më ka dhënë e më jep, për shembull, romani Gjumi mbi borë. Apo edhe romane të tjerë të mëparshëm shumica e të cilëve, për fat të keq (a të mirë?), nuk gjenden më nëpër librari dhe presin të ribotohen... Por, ndoshta, po gabo. Ku me e ditë autori i shkretë se cila vepër e tija është më e mira? Apo se kur ka arritur kulmin, siç thoni ju, dhe duhet ta thyejë penën e tij?”

Veprat e Ridvanit duken të thjeshta, dhe ndoshta ashtu janë. Për këtë ai shkruan: “Arti nuk është i thjeshtë sepse dëshiron të jetë i thjeshtë, por sepse dëshiron të jetë art”. Me këtë përsiatje të huazuar mund



të vështrohet një nga romanet më të vlerësuar të Ridvan Dibrës, “Legjenda e vetmisë”, botuar më 2012, nga “Onufri”, me një çmim kombëtar në Kosovë, “Rexhai Surroi” 2012. “Një libër që t’i shpërfille qëllimshëm nihilizmin e dyshimin e tejkaluar modern, por edhe ironinë e lojnat e shumë – përsëritura postmoderne. Një libër, në dallim prej të tjerëve para tij, sa më “jashtë meje”, sa më impersonal e objektiv. Një libër që, qëllimshëm, t’i lërë mënjane “artifcet kompozicionale”, duke respektuar deri në adhurim burimin e parë, domethënë legjendën. Ndërsa poetja Ledia Dushi, në ciklin kritik në “profile pas ’90-ës”, në Mapo Letrare, ka shënuar ndër të tjera për këtë autor, dhe veçanërisht për romanin se: “E përpunuar dhe e përzgjedhur më së miri, gjuha e Dibrës është fort poetike. Te “Legjenda e Vetmisë” veçanërisht, por edhe te “Gjumi mbi borë” ajo i mundëson një mënyrë të shkruarit të kthjellët, edhe pse të kursyer në dukje, dhe e prerë deri në krijimin e një imazhi të kthjellët. Dibra ka aftësinë ta shndërrojë personalen në universale nëpërmjet episodesh, detajesh, momentesh, sugjerimesh, intertekstualiteti, të cilat na shtojnë drejt pjesëmarrjes së pakushtëzuar në tekst, duke na bërë të pësojmë një metamorfozë të çuditshme”. Është konsideruar një lloj sfide romani i tij “Legjenda e vetmisë”, duke marrë zanafillën nga dy vargje të një legjende popullore: “Nana djalin ka qorrue, me gjaks t’burrit m’u martue...”, distik që e ka vendosur si një alibi, por dhe në hyrje të rrëfimit të tij. Në një intervistë për procesin e shkrimit, Dibra është shprehur: “Vazhdoj të kem aq shumë pikëpyetje brenda vetes, aq shumë dilema e pyetje pa përgjigje. Nëse ato do të reshtin një ditë (çka s’ka logjikë të ndodhë), nuk besoj se do të shkruaj më. Kuptohet, shtysë “frymëzimi” është edhe shumëçka tjetër që në një mënyrë a në një tjetër, lidhet me ato që thashë në fillim, domethënë me grindjet e mia të brendshme. Kjo ndodh edhe në ato vepra që lexuesit mund t’i duken krejt “larg meje”, si për shembull te romani im i fundit, “Legjenda e vetmisë”. Një konceptim i tillë i krijimit, bën që proza ime të jetë e varfër me personazhe; në romanet e mia ndesh jo më shumë një apo dy-tri karaktere. Në një kuptim, jam rrekur të bëj një prozë sa më vertikale: drejt thellësive e mistereve të qenies. Sa ia kam arritur, e gjykojnë të tjerët”.

Prej vitit 1995, që nis shkrimin me romanin e parë “Nudo”, jeta letrare e Dibrës ka qenë intensive duke vazhduar me tregimet “Prostituta e virgjër”, “Stina e ujkut”, 2000, romanet “Triumfi i Gjergj Elez Alisë”, “Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë”, 2003, “Kanuni i Lekës së vogël” – 2011, “Gjumi mbi borë”, 2016, dhe së fundi “Treni i muzgut” – 2017 etj., duke u bërë një nga zërat më modernë në letërsisë shqipe.

V.M



Albanolog, linguist, profesor dhe akademik shqiptar nga Presheva, Rexhep Ismajli është personaliteti më i rëndësishëm në dijet e shkencës gjuhësore shqiptare. Njohësi më i mirë i historisë së gjuhës, i teksteve të vjetra shqipe dhe letërsisë arbëreshe, Ismajli së bashku me akademikun Idriz Ajeti themeluan në kushtet e represionit serb, 38 vite më parë, Seminarin Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, që mbahet çdo vit, në gusht, në Universitetin e Prishtinës...

REXHEP ISMAJLI

E tërë jeta jonë kulturore është zhvilluar në një kundërvënie të nëntëshme

Intervistoi: Violeta Murati

(vijon nga numri i kaluar)

Dimë se nga Parisi, ku nisët studimet e para, u kthyet në Kosovë, për çfarë arsye? Ç'ishte kjo përvojë franceze?

Përvoja franceze për mua ka qenë vendimtare për çdo gjë pastaj. Kam pasur në vijim dhe për-voja gjermane, por ato kanë ardhur vetëm si plotësim, sidom sa i përket traditës së studimeve kra-hasuese. Deri më 1980 kam pasur kontakte intensive me rrethet ku jam sjellë në Paris dhe kam për-fituar nga komunikimet e drejtpërdrejta me zhvillimet e atjeshme. Ndjehe mirë që kam sjellë veprën e Saussure-it qysh më 1977, të Martinet-së edhe më herët – 1974, të Ducrot-Todorov më 1984, kam nxitur dhe ndihmuar përkthimin e Trubeckoit, të Sapirit, etj. Shpresoja që në një kohë të arsyeshme të kishim një korpus veprash themelore të gjuhësisë modern, çka në Shqipëri nuk ishte e mundshme, por zhvillimet nuk na dhanë kohë.

Dhe studimet vazhduan në Kosovë, çfarë po “kërkoni”?

Në Kosovë u ktheva me iluzionin që kishim në botën e atëhershme të izolimit për të bërë diçka në fushën e studimit me të cilën merresha dhe për t'i lëvizur gjërat përmes arsimimit. Si çdo iluzion i të riut, kishte ndeshje nga më të ndry-shmet. Megjithatë, nuk jam penduar. Njësoj në vitin 2000 u ktheva duke refuzuar profesurën në Universitetin e Mynihut.

Dy risi themelore, e para që lidhet me gjuhësinë bashkëkohore, pas Sosyrit, dhe si një strukturalist, me studimet që shkojnë përtej konceptimit tradicional të gramatikës, në trajtimin si sociolinguistikë ...” – këto kanë veçuar studiuesit mbi risitë e veprës tuaj studimore e shkencore? Ju vetë çfarë keni ndjerë në pak fjalë, se ka ndryshuar në veprën tuaj?

Në orientimin tim të parë dhe në vijim kam qenë i interesuar në radhë të parë për studimet e zhvillimit të gjuhëve. Kjo ishte arsyeja që e kisha kërkuar Martinet-në. Kjo rrethanë më çoi te zhvillimet strukturale. Funksionalizmi i Martinet-së e theksonte dhe rolin e aspektit social të gjuhës, pa e bërë atë të parmin. Rrethanat në Jugosllavi lidhur me shqiptarët dhe gjuhën shqipe pas vitit 1981 fare natyrshëm më shtynë drejt interesimeve sociolinguistike për të gjetur shpjegime dhe mundësi denoncimi për gjendjen që kishte arritur dhe sidomos për projektimet për rrëgjimin e saj më tej. Njëkohësisht, qysh herët kam pasur interesim për letërsinë. Në rrethanat që po përqëndrohesha gjithnjë e më shumë në gjuhësinë historike, në studimin e teksteve të vjetra të shqipes, në çështjet sociolinguistike, fare natyrshëm interesimi për letërsinë u shndërrua në interesimin për gjuhësinë e tekstit që sapo lindte.

Jeni autori kryesor që keni sjellë në gjuhësi drejtimin modern në linguistikë. Çfarë orientimi ishte kjo për gjuhësinë shqiptare? Pavarsisht çfarë ndodhte në Shqipëri.

Po, orientimi nga gjuhësia moderne në rrethanat shqiptare ishte shumë i dobishëm dhe hapte horizonte krejt të reja studimi, por njëherësh të vinte përballë zhvillimeve krejtësisht tradicionale që sundonin në Shqipëri në një shoqërim kushtëzimesh jetë a vdekje

me një ideologji kokëfortë. Më dukej se dobia nga ky orientim ishte e madhe, madje për mua tashmë ishte zhvillim pa kthim. Nuk konsideroja se ishte i nevojshëm ndonjë konfrontim, po më dukej më i dobishëm bashkëpunimi në fushat dhe aspektet ku mund të bashkëpunohesh. Dhe kjo ka qenë shumë e frytshme në kontaktet me të mëdhenjtë Çabej, Riza, po edhe me të tjerë. Në Prishtinë kishim mundësi komunikimi shumë substancial me Besim Bokshin dhe me brezat që erdhën pastaj. Mendoj se kam pasur fat dhe ia kam dalë që për katër dekada në Prishtinë të formësoja kursin dhe të jepja mësimet e gjuhësisë së përgjithshme me bazë në gjuhësinë moderne jo vetëm për studnetët e gjuhës shqipe po edhe për të tjerët, madje në një kohë

Ndërautorët e parë të studimeve sociolinguistike, cila ka qenë puna juaj për standardizimin e gjuhës, në studimin e këtij procesi?

Me çështjet e standardizimit jam marrë qysh herët, madje qysh si student, por ende pa qenë i orientuar në fushën e sociolinguistikës. Atëherë më interesonin çështjet konkrete. Nga viti 1981 nisa të merresha pak më me kujdes me këto çështje. Në atë fazë, më duket natyrshëm, më delnin përpara dy çështje të mëdha: pozita dhe statusi i gjuhës shqipe në Kosovë dhe në Jugosllavi dhe nevoja për të argumentuar një shkallë më të lartë barazie, në një anë, dhe forcimi i vetëdijes e selitja e përdorimit të një gjuhe unike letrare (standarde). Më 1974 kam qenë bashkëhartues i tekstit për mësimin e shqipes stan-darde për të huajt. Më vonë, sidomos në vitet 1987-88 kam shkruar më shumë për çështje të barazisë së shqipes me të tjerat në Jugosllavi. Më 1989 më morën në izolim, përvojë nga e cila nuk u ktheva dot në rrjedhat e mëparme, megjithatë, pas një kohe iu riktheva interesimit për statusin e shqipes, natyrisht, në kuadër të gjith atyre gjërave që bënim në vitet '90. Në çështje të studimeve sociolinguistike kam vazhduar të thellohem më tej pas vitit 2000 paralelisht me interesimet për historinë e gjuhës shqipe dhe në të dy këto fusha kam botuar libra të ndryshëm.

Jeni marrë me albanologjinë, historinë e studimeve shqiptare, keni një mendim se ku jemi sot? Flas për punimet, studiuesit apo përfshirjen e akademikëve...

Historia e studimeve shqiptare ka faza të ndryshme. Në pjesën e dytë të sh. XX studimet shqiptare ndër shqiptarë arritën nivele dhe rezultate që në shumë aspekte Tirana dhe Prishtina të shiheshin si qendrat kryesore për këto studime. Tani jemi në epokën e globalizmit në çdo fushë, prandaj edhe kemi sfidën që bashkë me kolegët e tjerë nëpër botë, ku gjithnjë e më shumë po ka dhe shqiptarë, të ndërtojmë një shkencë integrale albanistike, çka kërkon nga ne përpjekje më të mëdha për përbrendësim të metodave të avancuara gjetiu në fushat e ngjashme të studimeve. Edhe në këtë drejtim Seminari ynë ka disa merita dhe ofron disa mundësi.

Ju përmendni Andre Martinet me të cilin keni pasur një njohje të drejtpërdrejt me këtë personalitet, jeta brenda këtij komuniteti shkencor, sa kanë ndikuar tek ju? Më tej, cilët patën gjurmën më të madhe tek ju?

Si thashë, Martinet ka qenë profesor i jashtëzakonshëm. Prej tij kam mësuar shumë më tepër se një teori gjuhësore, atë të strukturalizmit. Kam mësuar shumë gjëra për natyrën e hulumtimit shkencor, po edhe për raportin ndaj mendimit tjetër e ndaj tjetrit. Sigurisht që do të isha i lumtur të kisha mësuar sa më shumë nga një mendje e atillë. Ai më ka mësuar gjithashtu që të mos mbetem rob i të mësuarave, qoftë dhe nga ai.

Ju jeni shprehur për rikonsiderimin apo ripërshtatjen e standardit në pajtim me nevojat e reja të krijuara në shoqëri... çfarë keni pasur parasysh me këtë?

Më saktësisht jam shprehur për nevojën e zgjerimit të hapësirave të përdorimit, të përfshirjes së varieteteve të tjera brenda standardit, të krijimit të një qëndrimi më permisiv ndaj realiteteve gjuhësore dhe për dy arsye kryesore: realiteti i folur, kontaktet e mëdha si kurrë më parë, aksesit në publik i të gjitha varieteteve, e bëjnë të domosdoshme një hapje të tillë; kjo e bën të mundur amortizimin e tendencave të tjera, në një anë, dhe, çka është shumë e rëndësishme, sjelljen në përdorim të potencialeve të optimalizuara të shqipes. Bashkë me këtë do të kishim dhe një përvojë përdorimi më të lirshëm, me më pak pasiguri gjuhësore. Duhet të jemi të ndjeshëm që të mos e çojmë më tej përshtypjen e disave se paska ndër shqiptarë që nuk e ditkan gjuhën e tyre, se ajo gjuhë qenka pronë e dofarë gurve që vetëm ata ditkan të dallojnë të mirën nga e shtërkëqura dhe që, në rrethanat ku po vihem gjithnjë e më shpesh, dikush të dëshpërohet. Nevoja për optimalizimin e potencialeve shkon paralelisht me mundësinë e aksesit që është zgjeruar shumë. Në anën tjetër, kemi tërë një trashëgimi shumë të shtrenjtë nëpër varietete të ndryshme, prej së cilës nuk mund të heqim dorë ashtu lehtë.

Një vend zë në studimet tuaja edhe poezia arbëreshe, rumune, franceze, dhe ajo italiane – përse erdhi ky interesim?

Thashë, prej fillimit kam pasur interesim për poezinë dhe për letërsinë. Në fillim të viteve '70 ne për arbëreshët dinim më shumë si për një traditë tonën gati të vdekur. Vizitat në Itali dhe ardhja e arbëreshëve në Kosovë, kontaktet me Francesco Solanon e të tjerët më shpërfaqën një realitet tjetër: atje kishte një poezi të gjallë dhe me vlera. Këtë desha ta paraqisja më 1978 dhe besoj se u bë me sukses. Rumanisht kam mësuar qysh në Paris për nevoja të studimeve ballkanike. Gjatë mësimet pashë se atje kishte një poezi që më pëlqente shumë, ndërsa ne nuk denim gjë për të. Poezinë, e vërteta, e kam pëlqyer gjithnjë dhe prandaj kam përkthyer vazhdimisht, qysh si student nga poezia moderne frënge. Kur më liruan nga izolimi më 1989 u ndjeva në një gjendje dëshpëruese për shkak të trajtimit shnjerrëzor. M'u kishin topitur dhe shprehitë e të shkruarit, kështu që gjatë asaj vere e pak më tej u mora më intensivisht me lexime e përkthime poezish, ndër to diçka nga impresionizmi gjerman, diçka nga poezia oksitane, nga poezia baske, etj. Kishte aty dhe italianë e ndonjë amerikan. Ishte libri që më ndihmoi të bindja veten se e kisha superuar një gjendje.

Nisur nga rrethanat e reja të krijuara, të shkëputjeve të komunikimeve me Serbinë, çfarë ka mbetur nga mitet e mëparshme?

Mendoj se raportet me Serbinë në Kosovë dhe te shqiptarët e Jugosllavisë kanë qenë pak më të distancuara gjithmonë. Edhe nënat dhe gjyshërit tanë thoshin: jemi në Serbi, Sërpi i parë, Sërpi i dytë, ashtu si Bugari i parë, Bugari i dytë. E tërë jeta kulturore zhvillohej në një kundërvënie të nëntëshme. Komunikimet i kemi pasur për një pjesë të detyrueshme dhe prej tyre po ashtu një shtresë njerëzish ka mësuar. Negativitetet që vinin si pasojë e ambicieve imperiale dhe pushtuese të politikës serbe i kishin fryrë edhe më shumë distancimit dhe nevojës për dallim. Kjo i ka mbuluar aspektet e tjera të kontakteve patjetër me interes dhe të dobishme. Këto aspekte të tjera duhet të shihen, p.sh. në letërsi, në studime, në kulturë. Vetë kam përkthyer poezi shqipe në gjuhën serbokroate (një libër të F. Arapit, një të Rr. Dedajt, pastaj poezi të zgjedhura të E. Bashës, I. Kadaresë, poetëve arbëreshë, A. Podrimjes, etj.), por në fushën e gjuhësisë më shumë

kam ndjekur traditat frënge. Për një pjesë, sidomos për periudhën e strukturalizmit, më kanë interesuar shumë autorët kroatë. Në pjesën e studimeve ballkanike dhe të historisë së gjuhës vazhdoj të ndjek me vëmendje se ç'po ngjet në ato tradita. Kuptohet që jam përpjekur të shoh gjithçka është shkruar në raport me gjuhën shqipe.

Libri “Tekste të vjetra” merret si referencë e dorës së parë në studimet akademike. Botuar në vitin 2000, nga Dukagjini, voluminoz, ju paraqisni në gjerësi të madhe, autorët shqiptarë të shek. XVII: Budin, Bardhin dhe Bogdanin, kur Buzuku dhe Matrenga ishin botuar. Çfarë nuk ka mjaftuar nga botimet e deritanishme nga ky korpus letrar?

Me tekstet e vjetra, me gjuhën dhe aspektet filologjike të tyre jam marrë vazhdimisht qysh në vitet e vona '70. Korpusin e teksteve të shekujve 18-17 e kam ndjerë nevojën ta paraqitja në një formë të përmbledhur për nevojat e kursit që zhvilloja në Mynih. Disa prej autorëve dhe teksteve të asaj kohe ishin studiuar mjaft mirë nga brezi i mëparshëm i filologëve dhe gjuhëtarëve tanë e të tjerë: J. Rrota, M. Roques, E. Çabej, N. Ressuli, S. Riza, M. Camaj, G. Svane, M. Sciambra, etj., kështu që nuk ishte punë e vështirë. Në disa pjesë (Buzuku, Bardhi, Budi, pjesërisht Bogdani) kisha dhe ndonjë hulumtim timin, ndërsa libri doli i mbledhur në një tërësi, ashtu siç e kishte klasifikuar më herët S. Riza, i cili kishte bërë një punë të ngjashme me më shumë përqëndrime në pika të veçanta. Sot studimet e teksteve të vjetra kanë kaluar në një fazë të re, pjesërisht edhe falë teknologjisë informatike, kështu që kemi botime kritike të Bardhit (B. Demiraj), Bogdanit (A. Omari) ashtu siç kemi botime shumë cilësore përsa i përket punës filologjike tek arbëreshët me F. Altmarin në Kalabri dhe M. Mandalanë në Sicili. Korpusin arbëresh e kemi tashmë thuaja të plotë, por edhe tjetrin në arealin verior tashmë e kemi në një pjesë të mirë. Më duket se duhet të vazhdojmë më tej me autorë të sh. 18 e pjesërisht edhe 19 për të përmbledhur një traditë të rëndësishme. Secili brez e ka mënyrën e vet të studimit dhe në këto fusha kjo bie në sy qartë: Çabej ndryshon shumë nga Rrota, po edhe Resuli, Riza ndryshon nga të tre sa i përket fokusimit dhe mënyrës së trajtimit, Camaj sjell madje përqëndrime të reja.

Kemi pasur dhe studime të traditës së shkruar me alfabet arab, fushë në të cilën janë shquar më herët O. Myderizi, H. Kaleshi, I. Ajeti, etj. Tash kemi një grup orientalistësh në Prishtinë e në Tiranë që po vazhdojnë të merren seriozisht me këto hulumtime. Ne ende jemi në fazën e eksplorimeve jo të barabarta të teksteve shqipe që janë me alfabetë të ndryshme dhe në kohë me lëvizje. Mendoj se ka ende punë për të bërë.

A duhet të kemi një normë të gjuhës shqipe, a është nevojë në kohën e sotme? Nëse, po, a mund t'i përfshijë norma gjithë varietetet e gjuhës përshembull për t'u marrë vesh si me shqiptarët e Kosovës apo Maqedonisë? Sa mund të tolerohet në këtë drejtim?

Po pa asfarë dyshimi. Norma është e nevojshme. Norma ka shtresëzime, ka nivele dhe realizohet në situata të ndryshme. Norma drejtshkrimore është një gjë dhe ajo thuaja se i plotëson të gjitha kërkesat për të gjitha varietetet (kuptohet, me shpjegimet që do të duheshin lidhur me pasqyrimin e gjatësive sipas sistemit me ë në rrokjen vijuese dhe elementeve të tjera morfonologjike, siç ngjet në të gjitha gjuhët e botës). Pak më shumë probleme dalin në rrafshin (morfo)sintaksor, por edhe për to ka mundësi të gjenden zgjidhje përmes dyshorëve apo përmes përshtatjeve të tjera. Në fushën e leksikut norma gati nuk ka kuptim, aty thjesht duhet të heqim dorë nga purizmi dialektor dhe t'u japim folësve kënaqësinë ta ushtrojnë kreativitetin e tyre në përdorimin e gjuhës së vet. Varietetet e shqipes, sidomos në një nivel përdorimi kulturor, nuk paraqesin vështirësi të mëdha të kuptuarit të ndërsjellë.

Ekziston një Këshill Ndërkademi për Gjuhën Shqipe, e themeluar nga dy akademitë e shkencave me kërkesën dhe nismën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në ç'drejtim ka funksionuar, i cili jo pak herë është bërë objekt debatesh në media, sidomos për drejtshkrimin?

Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe është themeluar më 2005 dhe ka funksionuar si institucion me dy bashkëkryetarë dhe pa buxhet të vetin. Këshilli ka funksionuar ashtu që për çështje të ndryshme të diskutimeve në fushat e drejtshkrimit apo të tjera kishte caktuar grupe specialistësh në Tiranë dhe në Prishtinë, ndërsa Këshilli merrej me diskutimin e prurjeve të këtyre specialistëve, propozimet e të cilëve ndonjëherë i miratonte, herë të tjera jo, sipas bindjes së anëtarëve dhe diskutimit në Këshill. Deri në vitin 2014 është përmbyllur një cikël diskutimesh dhe përfundimet e tyre janë bërë publike dhe mund të përmbledhen në një botim të veçantë. Këshilli ka marrë vendime në bazë të mirëkuptimit dhe të paktimit në shumicë të madhe të anëtarëve. Në fillim ka provuar të punonte me miratim të plotë, por ndërkohë u pa se kishte tendenca për të krijuar obstakle (shpesh nga ndonjë anëtar), prandaj u hoq dorë nga kjo. Përbërja e Këshillit ka ndryshuar shpesh, për shkak se ndërkohë kishin ndërruar jetë anëtarë të tij

(F. Raka, Sh. Demiraj, R. Nesimi, I. Bajçinca, A. Zymberi, I. Ajeti), ndërsa zëvendësimet jo rrallë sillnin edhe vështirësi. E. Lafe ka dhënë dorëheqje nga Këshilli. Ka pasur dhe vështirësi që buronin nga gjendja e vazhdueshme reformuese në Akademinë e Shqipërisë. Diskutimet për çështje të tilla janë normale. Jam përpjekur t'i ndiqja dhe të nxirrja përfundim nga to, por mendoj se shpesh janë shoqëruar me inate, hatërmetje e elemente të ngjashme. Kuptohet, në mënyrën e punës që kishte zgjedhur Këshilli asnjë individ, as bashkëkryetarët, nuk kanë pasur mundësi të impononin ndonjë qëndrim, po pranoheshin vetëm ato që vërtet shiheshin të tilla nga shumica dërmuese, për të mos thënë nga të gjithë. Këshilli është përpjekur të bënte një punë të dobishme me gjithë vullnetin e mirë dhe pa buxhet, ndërkohë që institucione me buxhete dhe detyrime të bënin hulumtime specifike në ato fusha nuk i kishin bërë ato. Kjo e vështirësonte skajshëm punën e Këshillit.

Për këto probleme, ne, si model gjuhësor, shpesh i referohemi Francës, për traditën e kultivimit të gjuhës. Disa janë të mendimit se kujdesi për gjuhën duhet të bëhet çështje ligjore, kam parasysh qoftë Shqipërinë, por edhe Kosovën.

Modelin francez e kam studiuar me hollësi. Atje ka një Akademi që merret vetëm me çështjen gjuhës dhe të fjalorëve, ka pafund institute hulumtuese për aspektet e ndryshme dhe ka një Delegacion të përgjithshëm të gjuhës frënge dhe të gjuhëve të Francës që është formuar me shndërrimin e Komisarariatit të përgjithshëm të gjuhës frënge dhe që ka për mision të animojë në eshëlonin ndërministerial politikën gjuhësore në Francë, kohët e fundit lidhur me gjuhën frënge dhe me gjuhët rajonale. Është i vendosur në Ministrinë e Kulturës dhe autoritetin ia jep drejtpërsëdrejti kryeministri. I deleguari (gjithnjë linguist i shquar, si B. Cerquilini, Xavier North apo Paul de Sintey) ka kompetenca të mëdha dhe detyrime edhe të harmonizimit me instancat në Kanada, në Belgjikë, në Zvicër, në Senegal). Mund të thuhet se në fakt kemi të bëjmë me një ministri të

tërë. A kemi bazë krahasimi? Por edhe në Francë, ku janë të njohura përpjekjet për zgjidhje ligjore dhe është nxjerrë ligji, po të pyesni specialistët, shumë shpesh do të thoshin se më mirë është të mos dihej se ka një ligj, sepse edhe efekti është i parëndësishëm, edhe danga se çështjet e gjuhës po përpiqen t'i zgjidhin me detyrim. Nuk ka dyshim se sa i përket përdorimit të gjuhës duhen zgjidhje ligjore (për shembull, qarkullimi i mallrave nuk mund të lejohet pa shënimin e nevojshëm shqip; qarkullimi i barnave/ilave nuk mund të lejohet pa shpjegimet shqip: firmat, diçiturat, etj. duan bërë me shpjegime të qarta shqip, por nuk mund t'u themi njerëzve se ligji thotë farmaci, jo barnatore, ulje jo zbritje çmimesh, pastičeri jo ëmbëltores, jepi in dietro/shko mbrapa, etj).

Si ka qenë bashkëpunimi me Tiranën? Pyes qoftë për atë akademike, ku shohim më pak bashkëpunim, krahasuar me atë universitare ku ju jeni më i përfshirë.

Bashkëpunimi midis dy akademive është zhvilluar prej kohësh mbi bazë protokollesh që përtërihen përkrye dy vjetësh. Për të pasur bashkëpunim, secila akademi duhet të ketë rrethana të favorshme për zhvillimin e veprimtarive në hapësirën e vet. Më ka rënë të kem bashkëpunim me kolegët dhe me kryetarët e Akademisë në Shqipëri pas Aleks Budës. Ashtu si në Prishtinë, edhe në Tiranë të gjithë e kanë dëshiruar këtë bashkëpunim sa më të ngushtë. Janë zhvilluar dhe zhvillohen veprimtari të ndryshme të përbashkëta, por ka pasur dhe mund të ketë edhe më mospajtime apo mosharmonizime. Por akademitë janë institucione konservative dhe nuk mund të përshtaten sipas ritmit të ndërrimit të shefit të partisë, apo të zëvendësojnë institutet hulumtuese, që ne si shoqëri nuk po ia dalim t'i vëmë në funksion efikas. Përpara edhe bashkëpunimi midis universiteteve bëhej kështu. Nuk jam shumë i sigurt se tani po vazhdon më ashtu. Ka pasur dhe atje njëanshmëri. Jam plakur në Universitet (43 vjet mësimdhënie). Para studentëve në Tiranë kam pasur mundësi të dilnim vetëm një herë në një orë prej 45 minutash bashkë me Besim Bokshin, ndërkohë që gati askush nga brezi im nga Universiteti i Tiranës nuk kishte mbetur pa dalë para studentëve tanë madje pa kufizime. Në konferenca shkencore kemi pasur bashkëpunim më të mirë. Tani më duket se nuk ka më protokolle, por bashkëpunimi bëhet sipas interesave. Nuk i di rrethanat në detaje. Seminari është institucion që ia ka dalë ta ruajë bashkëpunimin, megjithë vështirësitë.

Jemi në një situatë të re të përdorimit publik të gjuhës si tregu i librit, mediat, gazetatat, - çfarë mendoni se nuk shkon në këtë “bashkëjetesë”? Kur niveli i gjuhës është rritur, a mendon bashkarisht gjuhësia shqiptare, sot njësoj në të gjitha hapësirat ku flitet shqipja?

Në fushën e tregut të librit, të mediave, të gazetave bashkëjetesa më duket diçka që nuk shkon. Në Prishtinë nuk shiten gazetatat e botuara në Tiranë dhe e kundërta. Në Tetovë i gjen gazetatat e botuara në Beograd a Sofje, por jo ato të Tiranës e Prishtinës. Portalet dhe mediat elektronike e kanë zbutur pak gjendjen dhe ato po na i japin të gjitha lajmet dhe eksese menjëherë. Por shikoni pak strukturën e lajmeve apo të emisioneve dhe referencat sipas hapësirave dhe vendit prej nga është medium. Sa i përket librit ka edhe më shumë për të dëshiruar. Në Prishtinë nuk ka libër të botuar kudoqoftë, sidomos në Shqipëri, që nuk gjindet në treg dhe kjo është begati. Nuk jam i sigurt që ndodh kështu në Tiranë. Kam dëgjuar arsyeime që thonë se nuk po shiteshkan, etj. Po tregu i shpërndarjes së botimeve me tenderë qeveritarë a bën fare diferencimesh? Po tregu i leximeve të detyrueshme? Në rrethana të tilla nuk ka shumë hapësirë për të menduarin e përbashkët të gjuhëtarëve në hapësirat e ndryshme. Në të vërtetë, nëse kemi të bëjmë me të menduar, nuk po shoh si mund të jetë ai i përbashkët. Por në fushën e standardit dhe të planifikimeve ndërmarrjet e përbashkëta janë të kuptimshme dhe të domosdoshme. Shpresojmë të ndodhin në të ardhmen. U bë abetarja e përbashkët, por shkollat në Kosovë e përdorin atë, ndërsa shkollat në Shqipëri, më kanë thënë, kanë në përdorim disa. Ç'kuptim ka marrëveshja?



Portreti nga Ina Lajthia



TRIESTE

Gentur Lleshi

TRIESTE

E pashë natën, m'u duk vetja në ëndërr. Mëngjesi më gjeti zgjuar, qerpikët m'i kishte ngjyer me tis të bardhë agimi i çuditshëm i atij qyteti. Dija pak gjëra për Triesten. Di që im atë ka shkruar për të, apo jo babi? Di dhe nuk di asgjë.

Pika ime e dobët janë flokët. Para pasqyrave të mëdha të Triestes i rregulloja flokët, i shtrija vazhdimisht. Kisha dëshirë të më pyeste deti për diçka. Valët e tij vinin së largu nga Durrësi. Këmbët e mia u lagën dhe nuk ndienin asgjë. Prisja që era të më merrte në krahë dhe të më çonte atje larg në shtëpizën time, të më çonte në vendin tim.

Më këputi në mes malli. Më dridhet çdo fjalëz që pëshpëris në buzë. Trieste është hijerëndë dhe as që do t'ia dijë për mua. E di, ajo nuk më njeh ende. Njerëzit e Triestes më duken shumë të plakur. Fëmijë nuk ka nëpër rrugë. Ka fëmijë nëpër parqe, sigurisht, por unë nuk kam kohë të rri nëpër parqet e këtij qyteti. Unë kam ardhur këtu të nis letrën dhe dy plaçka me shokun tim Gjeroveni, që po kthehet.

Unë, jo, nuk kthehem. E ndiej se jeta ime u thye dhe unë do të jem i përjetshëm këtu. Vendosmëria i dallon burrat, apo jo?

Trieste duket sikur m'i lexon mendimet dhe befas rënkon.

Ujët e detit këtu është tepër i rëndë.

Fytyra e Dante Alighierit, e gdhendur nga era, atje në hyrje të Triestes, pranë Miramares, duket sikur është mbështetur mbi sipërfaqen e detit që mediton diçka. Nganjëherë Miramare më afron me Marmiroidin e Orikumit në Vlorë. Histori atdhedashurie të rrënuara keq, madje edhe të sëmura...

Prandaj, ndoshta dhe deti rënkon.

Largohem. Nuk rroj dot mes psherëtimave. Më rëndon një mendim dhe mezi pres sa të jem në dhomën time. Dua të gdhend diçka me gishta ose të paktën të gdhend disa fjalë mbi letër.

IKJA

Isha betuar që të mos i kthehesha kurrë asaj dite. Por dikush, me një fshehtësi të çuditshme, më mëson, më pëshpërit. Tani, vetëm tani, një çast. Shkruaju, ata duhet të dinë gjithçka. Ata i bën me krahë shkrimi yt. Mezi presin, ashtu si nuk gjej dot një pëllëmbë vend ku të jem vetëm dhe të lexoj letrat, shkrimet.

Ikja ime ka qenë e çuditshme. I kërkova babit 25 lekë për kursin, m'i dha. Ika me Dritan Shemen dhe Armandon. Ndjeva qysh në rrugë një trazirë fjalësh e thirrjesh. Te kinoklubi "Tekstilisti" takoj Ervin Fugën. Një turmë djemsh po hipnin nëpër autobusë.

Eksod. 6 mars 1991.

Ikim? Ikim dhe ne! E po, ikim! Kaq.

Do të merrnim leje? E kush të jepte leje? Bah! As që mund të mendohej.

Berat-Lushnje asnjë fjalë. Pasdite e vonuar që kuqëlonte me trishtim. Rrugat me gropa heshtte më keq se ne. Pemët e zhveshura mbanin frymën me një elegancë lakurike.

Unë dhe Ervini ngjeshur, në këmbë, në mes të autobusit. Nxehtësia e trupave përcohej e ftohtë. Frymët rrinin pezull. Njerëzit e ndienin peshën e largimit. Sytë i lëviznin, por asgjë nuk shikonin. E panjohura, që pas hapit të parë, na shikonte me një sy pushke.

Ne po iknim. Asgjë nuk durohej më.

Lushnje. Stacion i zhurmshëm nga njerëzit. Stacion pa jetë. Platforma buzë shinave e mbushur plot. Treni i lodhur po vonohej. Dhe vonesa vetë peshonte si gur mbi zemrën time. «Po u nise, mos e kthe kokën pas!» «Po vendose, mos diskuto më!» Këto fjalë të gjyshit tim të mirë e punëtor, një burrë i fortë, me karakter dhe nja dy metra i gjatë, më jepnin zemër.

«Gentur!»

U tremba. Po ky zë i njohur? Ishte shoku im Ilir Çela. Thërriste diku nga larg. Atë çast klithi edhe lokomotiva që doli nga kthesa me vrapin e saj të ngathët. E dija, e merrja me mend që edhe në tren do

të mbytesha nga angështia. Kori i zërave kishte vetëm një temë, ikjen.

Vetëm kur zbritëm, në buzë të detit, në Shkozë e kuptova sa shumë qemë. Lumi i njerëzve duket edhe më i errët natën. Sytë e verbër të turmës drejt detit. Dritat e anijeve ia bënin me sy. Vrapin ynë i çmendur. Lumi i turbullt e i rrëmbyer po derdhej në det. Fryma u mbajt në anijen panameze. As vetë nuk e di sesi hipa. Nuk pashë askënd të më shtynte përmbi urë. Ne shtynim njeri-tjetrin. Deti klithte me zë njeriu. Deti qante si fëmijë. Deti qeshte i tmerruar. Anija ngarkohej e ngarkohej vazhdimisht. Vetëm një gjë s'mund të harroj. Uria më gërryente. Orën e dorës, një orë me bateri që ma kishte sjellë vëllai nga Tirana, ia kisha dhënë policit. Tmerri i vetvetes po kapërcehej me hapat e të tjerëve. Unë prisja dikë dhe ky ishte frymë, ngjeshje, qarje, një e qeshur e qelbur dhe e xhindosur. Trupat u bënë petë, thuajse u këputën në mes. Nata ishte e zezë pis, me yje të largët që talleshin me mjerimin tonë. Vështrimi ynë që nxirë nga vdekja që po na rrëmbente frymën.

Mesi i natës i rralloi njerëzit. Çuditërisht anija panameze që kishte shkarkuar çimento, kishte dalë në radë. Flitej që e paskëshin rrëmbyer nja dy shkodoranë që i kishin lidhur kapitenin dhe marinarët në kapiteneri e në sheshin aty pranë. Aty pas mesit të natës as vetë nuk e di sesi u gjenda në hambar. Si unë dhe qindra të tjerë.

Më kishte mbërthyer një gjumë vdekjeje. Teksa po çelte agimi. Fytyra e merakosur e mamit më doli përpara. Kisha qenë ëndërr me të. Vetvetiu makthi më mbyti. Lotët më qenë mbledhur në sy. Hambari me pluhur çimentoje i kishte tjetërsuar njerëzit. Ata vërtet qenë shfityruar. Dukeshin sikur vinin nga ca shekuj të largët të mbuluar ashtu prej pluhurit të mrekullueshëm të historisë. Asnjë nuk njihja.

«Sa orë po bëjmë në det?» - klithi dikush me zë të shuar.

«Po vete ora dhjetë!»

«Anija ka qëndruar!»

«Jo, jo, anija është prishur.»

«Po sikur të mos ndreqet?»

«Mos u bëni merak, do të ndreqet!»

«E zeza unë, kemi për t'u mbytur!»

Mes klithmave të shuara, mes frymës së uritur, mes pluhurit mbytur, mes të sharave, përqeshjeve, talljeve, rrëmujës, urisë sflitëse, tmerrit pa ngjyrë, i gremisur përballë vdekjes së sigurt, ashtu u mbushën dyzetetë orë në mes të Adriatikut.

Aty nga mbrëmja e ditës tjetër anija lëvizti. Në sytë tanë lindi sërish shpresa, sido që disi e vogël dhe me fytyrën e vdekjes që na shihte duke u zgërdhirë.

Ikja jonë e pati një fund. Mbërritëm në Bari. Turma gjysmë e vdekur u turr për të zbritur. Njerëzit hidheshin në mes të detit. Të tjerët shtyheshin. Britma. Kujë. Fjalë të ndyra. Hingëllima njerëzish të rraskapitur. Tmerr pa sy. Mekje. Mbrëmje me drita të zbehta që pasqyroheshin përmbi det.

Nuk mund të harroj dot çastin final. As vetë nuk e di si shpëtova gjallë. Gati u këputa në mes nga të ngjeshurit e turmës pas hekurave. Mbaj mend që kam lëvizur si somnambul dhe e kam parë veten të mbuluar me qeskë plastmasi. Ajo ishte dhoma e parë imja jashtë shtetit, gjumi im i parë jashtë, i mbështjellë me pelenat moderne të perëndimit. Kur kam qenë kërthi mami im më ka mbështjellë me pelena pambuku. Në këtë ikje, në lindjen time të dytë jam llahtaritur nga vetëdija makabre e pelenave. Të qarat e mia dhe ato të turmës brenda atyre pelenave nuk kishin më zë. Na duhej të hanim pas tmerrit të urisë dhe të flisnim diku buzë një kazerme të stërmbytur.

Ëndrra që pashë atë natë:

Vazhdimisht më përkundte mami im në prehër. Ajo nuk ngopej së qeshuri. Qeshja dhe unë nën pelena plastmasi. Befas do të më zgjonte një diell i vrarë, ndonëse ishte 9 mars 1991, pranverë, një pranverë që përpëliste buzët në një formë të çuditshme: as mallkim e as urim.

Shkëputur nga libri "Ëndrra e vdekjes sime"

I nderuar LEXUES,

siç rrëfëhet edhe në këto shkrime te vogla dhe aq madhështore njëherazi.

Them se duhen lexuar si "leksione" në marrëdhënien mes të shkruarave, shkruarit dhe lexuesit si "autor i leximit vetjak", procese në të cilat kalojmë të gjithë. Gentur Lleshi dogji shumë etapa në ngjitjen e fjalës së shkruar për tek letërsia si mision rrëfimi dhe, kësaj, fisnikërimi. Na ndodh të firojmë rrugës, teksa provojmë shijen e Fjalës që themi, gjë që ndodh më vështirë se kur dëgjojmë Tjetrin, aq më pak kur kemi të bëjmë me emra ende jo familjarë n zhargonin promocional të vlerave. Çmimi i Tjetrit ndodh të jetë më ndryshe nga të çmuarit tonë, dhe kjo na fut në borxhe! Si te mos vëmë re, bie fjala, që mes ndereve të kombit ndë letrat shqipe guxojnë të rrijnë bashkë edhe emra që ç'nuk kanë fjalosur në kohë të palirisë?

Si të mos trishtohemi kur hosanaja jonë e lë në heshtjen e kësaj Ikjeje kaq te bukur Genturin, teksa ç'nuk shtjellash false ngre në qiellin e vëmendjes së kohës gjithnjë të shtrenjtë...

Lexuesi i pa ndikuar vendos komunikimin me botën përtej që mbase nuk është tjetër veçse zgjatimi i shijes së artit të Fjalës së jetës në indeksin më tregues të saj.

Se, tek e mbramja, asnjë rëndësi s'ka për këtë respektim të pa-asnjë-interes, kalendari ditor që ne mbajmë për të kujtuar veten se kemi detyrime përditësie me njërin apo tjetrin që na ka lëvdur apo harruar së lëvduari...Tabela e Mendelejevit ka pafundësi vendesh bosh, dhe secili prej elementeve në të është pjesë e paneglizhueshme e Natyrës. Nuk janë aq të dendur në këtë botë, homazhe kaq të natyrshëm, sa ky që Lexuesi sapo shërbeu thjesht njerëzisht për Gentur Xh. Lleshin...Ne, për fat të bukur po aq, ishim dëshmitarë dhe të ftuar të bëhemi sa më të vërtetë në sjelljen tonë me Fjalën.

Faleminderit, Lexues !
Faruk Myrtaj

ERDHËM NGA UJI

Lediona Braho



NJË PEMË QERSHIE

Kush tha se jam një metër e pesëdhjetë e pesë
e që peshoj pesëdhjetë kilogramë?
Metrat dhe peshoret le të gënjejnë sa të duan,
askush nuk u beson më,
nuk u besoj më as unë,
qëkurse pashë shëmbëllimin tim
në bebëzat e një të vogli,
qëkurse dëgjova jehonën e zërit tim
në faqet e një mali,
mund të bëhem pema e qershisë pas kopshtit,
që ia hap krahët diellit,
pamaku i dritares ku ti mbështetesh
për të soditur detin...
Dhe nëse ti do që të bëhem sy për të të parë,
le të bëhem vetëm sy që të shohin ty.



DUA

DUA të vish të më marrësh erë,
në këtë natë të bekuar me dritë yjesh,
ku asgjë nuk pipëtin veç bulkthit që këndon
jashtë dritares
dhe frymës së rënduar mbi gjirin tim të hapur.
DUA në këtë natë me shi meteorësh,
që bien e shuhen në lëkurën time,
siç bien yjet e syve të tu
mbi liqenet e syve të mi.
Vetëm ti ma kupton gjuhën e dëshirës.



KËNGË VERE

Kështu je ti:
një koktejl i ëmbël që më mjalton,
mjalton gojën time,
gjuhën time,
qiellzën time,
më mjalton çdo qelizë.

Edhe pse s'i kam pëlqyer koktejlët,
sonde etje kam vetëm për një koktejl
të ëmbël mjalte,
si të ish' hera e parë dhe e fundit,
një ngjarje e rrallë,
po aq sa një eklips hënor,
mjalte i ëmbël
dhe

vetëm për mua,
vetëm për mua.

JAM SE DUA

Jam se dua,
ndryshe nuk do ta njihja këtë gjallim të ngadaltë,
që gjarpërisht rrëshqet barit të njomë
e qafës së hollë më përdridhet.

As kufijtë e lëkurës dot nuk do t'i shihja,
që vijën ta hiqja mes skajeve të dy botëve.

Dua, ndaj jam
dhe rritem si një rreth nga një pikë e vetme,
dhe bëhem miliarda pika
në ajrin që na ndan,
në ajrin që na bashkon,
në këtë ëndërr përjetësisht të bardhë,
përjetësisht të frikshme...



NJË DHOMË

Një shtrat i ngushtë druri mbështetur në mur,
mbi të,
një dritare sa një pëllëmbë
bën sikur më sjell dritën
dhe një dollap,
ngjitur me fundin e shtratit,
që veç ndërresave të zakonshme
mban dhe dy palë brekë mëndafshi
në rast se do të më hyjnë në punë.
Ah, po,
është edhe piktura e zverdhur e Natës me Yje,
kopje e dobët e një piktori amator,
që më kujton tek-tuk ndonjë mbrëmje kënaqësie,
dhjetëra libra të shpërndarë në katër qoshet e dhomës
dhe një ngrohëse që nuk ngroh.
Po veç të ftohtit ka gjëra më të rëndësishme
për të cilat duhet të shqetësohem,
si për shembull:
Sa është data sot?
Edhe sa ditë do mamaja të vijë e të më shohë?
Po gjyqi i babait, si vazhdon?
Po sikur ta ketë braktisur avokati?
Sa e sa pyetje më sillen në kokë,
por sado t'i bluaj në mullirin e mendjes,
asgjë nuk ndryshon me të vërtetë,
përveç dritares që zvogëlohet përditë,
në këtë dhomë të errët si gojë përbindëshi.



A KA DALJE....?

Në portën time,
në shekuj troket si i marrë,
herë si zog çukitës,
herë me fuqinë e trokut të një kali,
por sot vjen çuditshëm,
sa nuk di në do më gjunjesh
a në do më pushtosh,
vjen i lagur nga shiu i rrugës së gjatë,
i zi nga pluhuri i kohërave.

Përulësh para origjinës së botës.

Në natën pa skenar,
të dorëzohem si sorkadhja luanit,
trupi yt merr fuqi e bëhet i gjithi zemër,
ndërsa zemra ime parandjen stuhinë e gjakut,
kur ulërima del prej rropullive
nga gërvishtjet me thonjtë e zgjatur kohërave,
me etjen e hakmarrjes së lashtë.

A ka dalje nga ky pyll i dendur mështekënash?



ILUZION OPTIK

Një humnerë ju ndan, më thonë.
Çudi, pse nuk mundem ta shoh?!
E sigurt them:
Nuk ka humnerë,
kjo është vetëm një vijë e hollë!
Shihe mirë, më ulërasin
dhe unë rri e vështroj nga të gjitha anët.
Atëherë vija fillon të zgjerohet,
aq sa nuk u besoj më syve.
Një humnerë ju ndan, më thanë.
Mos fjalët e tyre i shtrembëruan ligjësitë?!



KJO NUK ËSHTË NJË POEZI

Kjo nuk është një poezi:
është një brengë e heshtur,
është një kuti shkrepëseje,
është një gotë e përmbysur
pas një bisede të lënë përgjysmë.
Ti nuk po lexon një poezi,
ti thjesht po çapitesh në shtegun
ku pena ime shkeli pak më parë,
në udhën e këtyre shkronjave
të mbledhura pa mundim,
që shpërndava pa vetëdije
në qoshet e letrës.
Kjo është një pseudopoezi
gozhduar në kryqin e mosarsyes
që pret të çlirohet
prej marrëzisë së gjuhës.



TELOS2

Te dera ia behu gruaja,
prej flokëve të egërsuar i doli një ulërimë
dhe gjoksi i saj i madh gulçoi.

U struka në dy krahë të mëdhenj
për t'i shpëtuar furtunës,
por mburoja u shkërmoq në duart e mia,
si prej një mallkimi parahistorik.

Në heshtje, ai e bëri zgjedhjen.

‘LULET E EGRA’ TË MAJLINDA RAMËS, ZËRI QË PRESIM!

Nga Kim Mehmeti

Proza është mjeshtri e të rrëfyerit dhe prodhim i ‘punëtorisë’ së quajtur imagjinatë, ndërkaq poezia është lulishte dhe pranvera e ndjesive, dhe andaj ajo është si ‘ylber’ që bart të gjitha ngjyrat e shpirtit. Dhe të paktë janë autorët që, po aq, sa janë mjeshtër të të rrëfyerit, pra, po aq, sa posedojnë begatinë imagjinative, të jenë edhe kopshtar të lulishtes së shpirtit.

Një nga shkrimtarët shqiptarë që, me të njëjtën mjeshtri rrëfen dhe ngjiz shqetësimet shpirtërore është Majlinda Rama, e cila, si mjeshtre e rrëfimit, e shpalos vetveten te romanet ‘Perandorët’ dhe ‘Zonja me të kuqe’, ndërkaq si poete, te libri poetik ‘Lulet e egra’.

Libri poetik ‘Lulet e egra’ shpërfaq një shpirt të tendosur krijues, si telat e violinës, të cilët, po aq sa prodhojnë tinguj të këndshëm, lëshojnë edhe zëra vajtues. Pra poezitë e këtij libri janë lumturi-dhembje të shkruara në një, por jo edhe pakënaqësi nga jeta, as atëherë kur je ‘bënë e atij që nuk të ka dashur kurrë’.

Thujse të gjitha poezitë e librit ‘Lulet e egra’ kanë një të përbashkët: janë të ardhura nga përtej shqetësimeve shpirtërore. Dhe të ardhura nga ajo largësi, ato nuk ka si mos jenë të begata me vizione poetike, në epiqendrën e të cilave qëndron universi njeri dhe njeriu vetë, si krijesë që ëndërron vetveten, siç do donte ta donin e të dashuronte.

Poezitë e Majlinda Ramës janë si fllad i gjatëpritur, i cili, me freskinë e vet, tregon se ka ardhur krijuesja që zë vend të rëndësishëm në bibliotekën tonë kombëtare. Ato janë edhe tregues si ndërlidhet vargu në një harmoni të plotë edhe atëherë kur nga brendia e tij dëgjohet klithma e dashurisë së munguar.

Në librin poetik ‘Lulet e egra’ ka disa poezi të përmasave antologjike, përfshi edhe atë me titullin ‘Dy gjysmat’, ku ecja drejt vetvetes dhe sa më larg asaj që, tjetër duam të jemi, përbën një udhëtim përplot ‘ngjyra që ta puthin shikimin’. Ngjyra nga të cilat Majlinda Rama e pikturon shqetësimin e saj si dhe kërkesën: “... harroji këto lot/ ne qeshëm sa deshëm e sa deshëm qamë/ rrugëve u endëm si dy Don Kishotë”.

Në fund të librit ‘Lulet e egra’ është poezia me titull ‘Lulet e bardha’ për të cilën kritiku ynë letrar, Ali Aliu, konstaton se, vargjet e saj janë ‘guaskë e mbyllur, e padepërtueshme’. Madje, jo vetëm kjo poezi, por edhe shumë të tjera nga kjo përmbledhje poetike, janë tregues se vetë njeriu është në të vërtetë si guaskë e mbyllur, e cila jo rrallë herë, edhe vdes pa u hapur fare dhe pa e parë askush margaritarin në të.

E në ndërkohë duhet shtuar se ‘Lulet e egra’ të Majlinda Ramës janë shumëçka nga pak: edhe përfytyrim i brendisë së guaskave të mbyllura,



edhe zëri që presim, zëri që duhet të na kumtojë të vërtetën se, ne nuk jemi, as atë që jetojmë, as atë që ëndërronjmë, por ai që kalon përmes tyre, ashtu siç ecet nëpër poezinë e mrekullueshme ‘Dy gjysmat’. Poezi që është në ballë të diademës së veçantë poetike, me të cilën Majlinda Rama e begaton thesarin poetik të shqipes.

DOLI NUMRI I RI I REVISTËS LETRARE “JETA E RE”

Në një vëllim prej 420 faqesh, posa ka dalë në qarkullim numri i ri i revistës letrare të traditës “Jeta e re”, i dyti për këtë vit. Të gjitha rubrikat e këtij numri, si dhe deri tash, sjellin autorë me peshë nga fusha e letërsisë, e kritikës letrare botërore dhe asaj shqiptare.

Proza fillon me tregimim “Era e jugperëndimit” të shkrimtarit turk me origjinë shqiptarë, një nga zërat më të veçantë të letërsisë së sotme turke, Onur Caymaz, për të vazhduar me Silvina Ocampo-n, shkrimtaren argentinase, që me burrin e saj, Adolfo Cesares, me motrën Victoria Ocampo dhe me mikun e tyre të pandashëm Hohe Luis Borhesin, përbënin plejadën më të ndritshme jo vetëm të letërsisë argentinase. Ocampo vjen me tregimet “Xhelati”, “Informacion për parajsën dhe ferrin”, “Enigma” dhe “Shtëpia si prej sheqeri”, kurse Augusto Monterroso, shkrimtar guatemalas me famë ndërkombëtare, prezantohet me tregimet “Të mirat dhe të këqijat e Horhe Luis Borhesit”, “Homo scriptor”, “Mister Taylor”, “Maska e vjetër”, “Miza që donte të bëhej shqiponjë” etj. Ndërkaq, shkrimtari italian Danniele Del Guidice me “Rikthimi në Jug” dhe shkrimtari anglez me prejardhje pakistaneze, Haif Kureishi, me prozën “Thashetheme”. Ndërkaq, nga autorët tanë janë prezantuar: Eqrem Basha me “Ruga nga nuk kalon askush”, Rifat Ismaili me tregimet e shkurtra “Në labirint”, “Gostia e djajve”, “Hija e jetës”, “Në skëterrën

e fatit”, “Varri i humbur”, Bajram Sefaj me “Tuneli”, Azem Qazimi me “Vasili, i përsosuri” dhe “Letër” dhe Kismete Hyseni me “Kur binte shi”.

Rubrika e poezisë nis me një cikël të gjerë poezish të nobelistes Wislawa Szymborkas dhe vazhdon me

autorin dhe shkrimtarin italian Umberto Saba, pastaj me Joana Gruia-n, poeten dhe romancieren e Granadas, të përkthyer në shumicën e gjuhëve europiane, pastaj James Baldwin, si dhe me poeten holandeze Garry Van Der Linen. Ndërkaq, nga autorët tanë me nga një cikël poezish në këtë numër të revistës janë paraqitur Xhavit Beqiri, Dije Demiri- Frangu, Serafina Lajçi, Skënder R. Hoxha, Selvije Rexhepi dhe Sulejman Pireva.

Në rubrikën qendrore të revistës Dossier, në një hapësirë prej 80 faqesh, vjen për herë të parë në shqip Richard Ford, një prej shkrimtarëve më të vlerësuar të kohës sonë dhe një nga stilistët më të mëdhenj të prozës amerikane. Rubrikës i prin teksti i Laura Barton-it me titullin “Zëra të tjerë, dhoma të tjera”, për jetën dhe veprën e Fordit, për të vazhduar me tregimet “I përkohshëm” “Të dashurit” dhe “Shooting the rest Area”. Rubrika pëfundon me intervistën e autorit me titullin “Masa dhe stili i pranimit”.

Rubrika e kritikës nis me tekstin prej 35 faqesh të Charles Altier-it me titullin “Ideja dhe ideali i kanonit letrar”, për të vazhduar me “Vetmia thelbësore” të Moris Blanshos dhe “Gjeografia e hijes” të Xhevat Karahasanit. Nga autorët tanë janë për t’u veçuar tekstet “Itaka-një simbol i madh ballkanik i Agim Vincës dhe “Kryeveprat Gege” të Kujtim M. Shalës. Po ashtu, në këtë rubrikë kemi edhe një vështrim të Xhemail Pecit për librin “Asnjë zë tjetër” të Sali Bashotës dhe “Prilli i thyer” i Ismail Kadaresë përballë “Kanunit të Lekë Dukagjinit” të Gentiana Bajramit.

Përkthyesit që kontribuan në këtë numër janë: Bajram Karabolli, Gëzim Aliu, Alket Çani, Belfjore Qose, Albion Zilfa, Edita Kuçi-Ukaj, Sulejman Dërmaku, Alfred Beka, Arben Idrizi, Erion Karabolli, Qerim Ondozi, Rexhep Maloku, Arta Hallaçi, Fatbardha Statovci, Arbana Rexhepi dhe Gazmend Bytyçi.



Botohet romani i shkrimtarit Luan Starova

“EMIGRIMI I NGJALAVE”: METAFORA METAFIZIKE E POLITIKE MBI FATIN E NJERIUT DHE RRUGËTIMIN E NJERËZIMIT

Nga Silvana Leka

Fjalët e fituesit të Çmimit *Goncourt*, Maurice Druon kishin qenë shtysë për vëmendje më të madhe edhe për vlerësime të merituar mbi romanin *Emigrimi i ngjalave* të Luan Starovës, për të cilin, mes të tjerash, ai shkroi: “*Udha e ngjalave* ndërlidhet dhe e plotëson me sukses “Sagën ballkanike” të Starovës. Ajo është një vepër alegorike, tejet përfaqësuese në letërsinë ballkanike. Romani shpërfaq një histori tragjike shekullore, që dëshmon për popuj me fate të rënda, i simbolizon familjet e shkulura me shpresa të përhershme kundërthënëse. Ai parashtron njëkohësisht pyetje ekzistenciale dhe metafizike, dhe kjo nuk është meritë e vogël”.

Ky roman, që sapo është publikuar nga “Botimet POETIKA”, përkthyer tashmë në shumë gjuhë dhe i vlerësuar nga kritikë të shquar letrarë, nga filozofë, shkrimtarë dhe estetë, vihet në ndjekje të linjës familjare të autorit, duke e filluar atë nga rënia e Perandorisë Osmane e deri në fillim të shekullit XX, me shembjen e Jugosllavisë e rënien e komunizmit në vendet totalitare staliniste, përfshi dhe Shqipërinë.

Pikërisht me këtë pamje, me kujtesën e disa dhjetëvjeçarëve të ndarë me kufi tokësorë dhe kufi uji, hapet romani *Emigrimi i ngjalave*: “Qëndroja aty, buzë një shkëmbi të madh që zgjatohej si ballkon mbi përjetësinë blu të liqenit. Prapa meje, në Maqedoni, qëndronte Manastiri i Shën Naumit. Një pallua, që çapitej me krenari përgjatë çatisë së kuqe, ia shtonte edhe më shumë bukurinë kësaj pamjeje të shenjtë. Vështrimi im kapërceu kufirin ndarës midis dy shteteve, që shenjohej nga një bovë thujse e padallueshme, dhe mbërriti në bregun më të afërt të Shqipërisë. Sytë u ngulën mbi qytetin tim të lindjes, Pogradecin, pikënisja e eksodit të fundit të familjes sonë, gjatë atij moti të largët të vitit 1942, pas të cilit u dënuam të qëndronim në tokën prej nga nuk do të ktheheshim më.”


Kjo është panorama e ndarjes, e veçimit me forcë të njerëzve nga njëri-tjetri. Nga ana tjetër *Emigrimi i ngjalave* gjurmon jetën e vendeve, popujve dhe kombeve e kulturave të izoluara e të ndara nga kufinj të gjithfarëllojshëm. Bashkë me këto gjurmohet edhe jeta e njerëzve me profesione të thjeshtë apo me profesione liberale, qofshin ata shqiptarë apo maqedonas, rusë të bardhë apo vendas. Të gjithë janë mbledhur buzë Liqenit, kanë ngecur aty, si ngjalat, që nuk e kryejnë dot ciklin e jetës. Aty e kanë ndërtuar edhe jetën, duke u mbështetur te njëri-tjetri, në kërkim të shtegut të ikjes, të kthimit në Amerikë, Rusi apo Stamboll apo të gjetjes së arsyes së qëndrimit të mëtejshëm në atë vend të ngjashëm me një labirint apo dajlan, ku gjithçka hyn, por nuk del dot më.

Përmes metaforës së ngjalave, krijesës ujore engmatike, si në poezinë e Montale-s, që hap librin e që në udhëtimin e saj epik i është bindur natyrës dhe jo kufive të diktuar nga njeriu, ky roman i Luan Starovës zbulon natyrën e mundimshme të asaj që bëjnë njerëzit për të mbijetuar dhe për t’i shmatur pengesat. Të rënda bëhen ato sidomos kur realizohen në emër të progagandës, të utopive dhe janë po aq artificiale sa edhe forcimet e kufive apo mbyllja e liqeneve dhe lumenjve me diga.

Edhe romani *Emigrimi i ngjalave* ka fillesa autobiografike, siç dhe më herët kanë pasur rrënjë autobiografike edhe disa nga romanet e spikatur të Luan Starovës, si “Koha e dhive”. “Muzeu ateist” apo “Librat e babait”, publikuar të gjithë nga botuesi i mirënjohur francez “Fayard”. Romani ka sërsh në qendër Babain, krijuesin e bibliotekës dhe të kujtesës së familjes së shkullur nga trualli i vet, bartësit të përvojave, urtësisë dhe historisë së përbotshme dhe të çdo individi të fisit. Por si vijim dhe si dallim prej veprave të përmendura, romani *Emigrimi i ngjalave* shfaq dukshëm përkrahjen dhe mbrojtjen e identitetit, gjuhëve, besimeve dhe familjeve shpesh të ndara prej ideologjisë. Personazhet e romanit *Emigrimi i ngjalave* janë të ndarë “piramidave ujore”, siç e ndeshim titullin në një botim. Jo vetëm klonet, piramidat dhe kufitë e ndërtuar nga njeriu, por edhe natyra duket se detyrohet nga regjimet staliniste t’i kundërvihen lëvizjes së lirë.

Në përpjekje për të kapërcyer historinë një shekullore ballkanike të shekullit XX nëpërmjet odisejadës së një familjeje, Luan Starova nuk përcaktohet dhe shpallet përmes metaforave të mbyllura lokale, por përmes sintagmës së “metaforës globale”. Duket se lindjen dhe funksionalizimin e “metaforave globale”, si pjesë e pandarë e *Sagës ballkanike*, një projekt jete për shkrimtarin Luan Starova, autori e koncepton si tërësi brenda gjinisë së romanit, e cila po ashtu nuk njeh kufij dhe nuk respekton ligje. Ndaj edhe romani autobiografik për këtë autor (si pjesë e traditës së romanit autobiografik europian, epoka moderne e të cilit, me gjithë versionet që i dikton autofiksioni, nis me Marsel Proust-in, por nuk përfundon me të) konsiderohet si hapësirë mendore e paskajshmërisë me të gjithë variantet e së mundshmes, por edhe e së rastësishmes.

Nga kjo pikë, brenda romanit *Emigrimi i ngjalave*



fillon gjallojë metafora e mërgimit, e arratisë, e shtegtit, e rrugëtimit, e ikjes në të gjitha format dhe e ciklit të pafundmë të emigrimit. Kësaj metafore i mbivendosen edhe të tjera, si metafora e izolimit dhe e daljes prej tij. Metafora e emigrimit pra, bëhet ura që vendoset ndërmjet ligjeve të natyrës dhe historisë së njeriut. Ajo mbetet rruga plot rreziqe e kalimit nga jeta drejt përjetësisë.

Por opusi narrativ i Luan Starovës, siç është vërejtur, nuk vihet në lëvizje vetëm nga faktologjia dhe nga ndodhitë autobiografike. Kjo vepër e gjerë dhe e strukturuar si një sagë ciklike, krijohet përmes përfytyrimeve të fuqishme, prej imagjinatës, armës më të fuqishme të këtij autori të shquar si dhe prej dhuntisë së tij të rrallë për të ngritur në nivel metafore globale edhe një ngjarje apo dukuri të rëndomtë në dukje, si shtegtimi mijërvjeçar i ngjalave. Sigurisht që kjo imagjinatë e Luan Starovës mbështetet në fakte, te ndodhi paradoksale dhe ngjarje absurde të cilat realiteti, sidomos ai ballkanas, i ofron me dorë të lirë. Autori i qëmton ato imtësisht, në një studim të thellë, anatomik që shpesh i merr atij po aq kohë sa ç’i duhet ngjalave të kryejnë ciklin e tyre jetik të emigrimit nga Ballkani në Sargase apo vetë autorit për të shkruar romanin.

Secila metaforë e rrëfimit artistik të Luan Starovës kalon përmes filtrit të jetës dhe jeta në këtë rrëfim epik dhe lirik njëkohësisht, pasi e kapërcen kufirin mes kulturave, gjuhëve, etnive e kombeve, bëhet pjesë e kujturës botërore, që i përket jo vetëm njeriut, por njerëzimit, për ta ndihmuar dhe për t’i shërbyer humanizimit të këtij njeriu të vënë shpesh në provë. Prej këtij realiteti ai nxjerr metaforat me vlerë universale, të cilat studiues të shumtë i kanë vënë re e jo të vërteta të thjeshtëzuar rajonale, të cilat krijojnë mite e mistifikim në vend të realitetit, qoftë ky edhe letrar, fiction, non-fiction apo autobiografik.

Në një artikull kushtuar “Sagës ballkanike”, akademiku Georgi Stardelov vë në dukje se te *Emigrimi i ngjalave* “...vendin e dhive e zënë ngjallat, si mbretëresha të ujërave liqenore, udhëtimi i fshehtë i të cilave në pjesën ujore të planetit tonë ka domethënie thelbësore në zbulimin e harmonisë ndërmjet njeriut dhe natyrës. Udhën e ngjalave Babai e sheh nga prizmi mitik, përkatësish metafizik, duke kërkuar dalje utopike, duke kërkuar vendin që nuk ekziston (toposin). Në këtë betejë Babai e sheh një epope të madhërishtme...Udha e ngjalave për Babain është rimishërim i gjallë dhe organik i udhës së madhe ndërmjet vdekjes dhe jetës.”

Ballkani i Starovës shfaqet si një Ballkan i ndryshëm nga stereotipi i njësuar me barbarinë ballkanike. Luan Starova vëzhgon nëse kjo barbari është prirje “e natyrshme”, “e lindur” apo e diktuar nga historia dramatike dhe e ndërlikuar e ballkanasve. Është theksuar se një paraqitje e tillë e Ballkanit prej Luan Starovës drejtpeshon medimin e paraqitur nga Robert Kaplan në librin *Fantazma e Ballkanit*, ku urrejtja dhe barbaria te ballkanasit paraqitet si një konstante e pandryshueshme. Pjesë e kësaj bote krijimi është edhe romani *Emigrimi i ngjalave*, kjo një vepër e rëndësishme dhe e çmuar kudo ku është përkthyer, që sjell kuptime të reja rreth Ballkanit, këtij rajoni të njohur në Perëndim më shumë për grindjet sesa për debatin e hapur dhe mirëkuptimin mes fqinjëve, siç është theksuar nga kritika.

Nga kritika:

ÉRIC FAYE: Ky roman është një metaforë metafizike, metaforë politike; “Emigrimi i ngjalave” pushon pak nga pak së qeni rrugëtimi i disa njerëzve të veçantë, për t’u shndërruar në një udhëtim të njerëzimit me zgjedhjet e tij, me ngurrimet e tij, me gabimet e tij.

VICTOR- A.-FRIEDMAN: Zëri letrar i Luan Starovës është thellësisht kozmopolit, duke qenë edhe veçanërisht Ballkanik dhe, ngandonjëherë, në mënyrë specifike, shqiptar. Identiteti shqiptar i Starovës është i butë, por i qëndrueshëm. Ai ka finesa me të cilën ai e pohon atë identitet, duke siguruar një kuptim shumë më të pasur dhe më të përmbajtur të asaj që është dhe nuk është “kombi”.

ROMANI I VIRGJIL MUÇIT — MBI NJË MJEDIS KU ËSHTË E VËSHTIRË TA RUASH ARSYEN, KUR BOTA HUMBET FILLIN

Nga Ledia Dushi



Borgesi shkruan: “Kurrë nuk kam lexuar një roman pa u ndjerë disi i lodhur. Dhe unë e kam këtë ndjenjë e veçanërisht kur vendos të shkruaj për atë libër sepse e di se autorët ngazëllehën kur lexuesit gjejnë kuptime të thella në shkrimet e tyre. Kjo gjë na bën me dije se edhe lexuesi ka pjesën e vet, ai mund ta pasurojë librin. Mendoj se, shkrimi dhe leximi ndërtojnë një lloj miqësie. Ky është caku vlerësues për një autor. Me librin “Piramida e shpirtave” jam njohur kur ai ishte në dorëshkrim në konkurim për çmimin “Kadare”, ndërsa me personalitetin e zotit Virgjil Muçi, shumë më përpara. Romani i Virgjil Muçit ndërtohet mbi një mjedis ku është e vështirë ta ruash arsyen, kur bota humbet fillin. Ndjeshmërinë e tij e ruan duke krijuar një “klime” të përshtatshme për shpirtin e tij. Kjo gjë nuk e pengon aspak të shkruajë për ndjeshmërinë e personazheve të tij. Shkruan me kujdes dhe kulturë. Lexuesi vendoset në rrugëtimin e jetës dhe në fund zbulon ose mendon për të vërtetën duke shkrirë kënaqësinë dhe dhimbjen në një çast të vetëm. Autori e di se është e vështirë të jesh i lirë nga pushteti i së kaluarës. Bëmat e saj shpesh jo vetëm vijnë si thirrje, e cila nganjëherë merr trajtat e një kërkese për drejtësi, por edhe si kujtesë e stërkalor me dhimbje e nostalgji. Ndjen edhe vështirësitë e të qenurit i lirë nga ai që e quajmë realitet modern që tek ne vjen disi i përcudun me emrin “tranzicion”. Mark Mara i ndjen të dyja këto dhe e di se është e vështirë të ndërtohet një satelit të së ardhmes në këtë vend ku gjithçka është groteske.

Ai humbet në këtë mjedis. Romani i Virgjil Muçit nis si tip letërsie e udhëtimit, merr frymë si letërsi e kujtesës dhe dëshmisë për diktaturën. Fillimisht paraqitet si roman i personazhit, i cili herë herë ka premisë të antiheroit, thuajse një vështrim prej prokurori të situatës. Ideja e përmbysjes së ideologjisë deri në ekstrem, nëse dikur ndaloheshin librat kundër komunizmit, tash librat ideologjik. Frika, paniku, pasoja nga ideologjia deri në një demokraci të “shpërdorur” Diku diku shfaqet edhe si roman i pasojës. Herë – herë qëndrimi i tij i ngjan personazhit të Konicës të Dr. Gjilpëra, të paktën në një rast.

Ka linjë të qartë fabulative, të lexueshme lehtë. Teksti dëshmon për një lidhje të mirë konceptuale mes sistemeve politike diktatoriale. Rrëfim i mirë i hapësirës/autorit, por edhe më i mirë rrëfimi i personazhit të persekutuar.

“Personazhi” i vërtetë i romanit është përditshmëria. I ngjan një lëmshi që pluskon sa në ujë aq në ajër. Në këtë lëmsh lëvizin njerëz që gjithnjë e më pak janë vetvetja ndërtojnë marrëdhënie me parimin, të gjithë kundër të gjithëve. Kjo gjë e mban të lidhur lëmshin. Mendoj se nuk është e lehtë t’i mbash, aq sa të mundesh, qoftë edhe në faqet e një romani, në një mjedis ku janë rrëzuar ato çka quhen bazat morale të jetës. Autori ndërton shtëpinë e groteskut të tij dhe e quan “bulevard pa qytet”. Robert Farka, personazhi qëndror e perifrizon kështu: “shoqëria e mbledhur në këtë dhomë në një farë mënyre është një miniaturë e shoqërisë së madhe që gjendet atje jashtë, ndaj ne nuk jemi në gjendje ta

rrokim me vështrimin tonë. Por, në fund të fundit, punë e madhe, mund të bëjmë edhe pa të; gjithçka na duhet e kemi këtu para syve. A nuk është edhe krimi pjesë e pandarë e jetës sonë, ashtu siç mëkati bashkëjeton me virtytin? Madje është kontrasti që krijon mëkati që e nxjerr edhe më në pah virtytin dhe e bën të shkëlqejë e të çmohet lart. Dhe e fundit, mos harro që këtu je në Ballkan dhe jo në Skandinavi. Mbaje vëth në vesh këtë që të them...” Në atë lëmsh pluskojnë gjallojnë *ministra, deputetë, biznesmenë, pronarë gazetash, drejtori i fondacionit AtDheu, pastori i kishës Adventiste...* Në fakt personazheve të tij u ka ikur vetvetja, ata lëvizin vetëm si formë. Gjithçka lëviz brenda një “demokracie” të pakontrolluar ku injoranca e mbrapshtia mbartin maskën e arsyes. Autori zgjedh groteskun, ndoshta e vetmja mundësi artistike për të na dhënë mjedisin politiko-social ku ngjarjet zhvillohen. Grotesku në këtë roman mundëson bashkekzistencën shpërthyes midis të qeshurës dhe të qarës. Ndjekim gjëra reale me personazhe groteske që duket se në filozofinë e jetës së tyre funksionon thënia: Jeta është gjithçka që ti kërkon prej saj. Mark Mara, një qytetar amerikan me prindër shqiptarë, që sapo shkel në tokën e prindërve të tij, përplasat me një mjedis që i ngjet një shpelle, në muret e së cilës lodrojnë figura të ndërthurura në mënyrë të çuditshme. E ndjen se në këtë vend gjithçka mund të ndodhë.

Vinte në tokën e të atit, i cili, megjithëse kishte kaluar më shumë se gjysmën e jetës në një nga qytetet më të mëdha të botës, krahasimet dhe figurat i lidhte me fshatin ku kishte lindur.

Kishte nevojë për paqe dhe e ndjente se mund ta arrinte vetëm me ekuilibër shpirtëror.

Kështu nis të ndërtojë “Piramidën e shpirtave”. Dionisi ishte i plotfuqishëm në këtë vend.

E gjen të mbështjellë me “buzëqeshjen përtallëse”, i gatshëm të tregojë ngjarje që flasin për regjimin që kish kaluar. Dëgjuesit i ndiqnin me shumë dëshirë. Në kohën në të cilën jetonin, s’kishte gjë për të treguar. Njerëzit ishin ndarë në të mirë dhe të këqinj dhe pastaj në të këqinj dhe të mirë dhe kështu mund të ishin, o të gjithë të mirë, o të gjithë të këqinj.

“Mark Mara piu një gotë me Dionisin dhe iu krijua përshtypja sikur kishte një jetë në këtë vend. Kjo ndjesi iu tret në trurin e lodhur dhe i bulëzoi një mendim tjetër: ç’dreqin kërkoj këtu!”

Janë mendimet që vrasin përditë shpirtin e njeriut. Kështu Dionisi e vuri në gjumë për t’u takuar herë të tjera. Dionisi në këtë libër vjen si fis i ish zyrtarëve të lartë të komunizmitpor që nuk i përkiste askuj, veç vetvetes, dhe “nuk lypte mirëkuptimin e asnjëres palë, por vetëm shpirtit të tij të lirë”. Ndoshta është elementi i parë që jetëson dhe ndërton romanin. Dita e re e gjeti në një takim të rastit por jo të rastësishëm. Takime që do ta shoqërojnë autorin në rrugën e zhgënjimit të tij. Arsyeja që ai e mendonte vizitën në atdheun e prindërve (kështu e quan) si kalim nga ferri në purgator ishte se ferri dhe purgatori s’mund të jenë në të njëjti vend.



Kompozitorja e famshme britanike Cheryl Frances-Hoad ka kompozuar së fundi një pjesë të re, të titulluar “Tales of the Invisible”, të cilën do ta ekzekutojë me Kuintetin e saj të Klarinetave, bazuar në prologun e romanit të parë të autorit shqiptar, Gazmend Kapllanit. Bëhet fjalë për romanin “Ditar i shkurtër kufijsh” (me titullin në anglisht “A Short border Handbook”) përkthyer në gjuhën angleze, përshtatur më herët për skenë teatri në Danimarkë, Greqi dhe Kili...

“DITAR I SHKURTËR KUFIJSH” ROMANI I GAZMEND KAPLLANIT FRYMËZON KOMPOZITOREN E FAMSHME BRITANIKE

Kompozitorja e famshme britanike Cheryl Frances-Hoad ka kompozuar së fundi një pjesë të re, të titulluar “Tales of the Invisible”, të cilën do ta ekzekutojë me Kuintetin e saj të Klarinetave, bazuar në prologun e romanit të parë të autorit shqiptar, Gazmend Kapllanit.

Bëhet fjalë për romanin “Ditar i shkurtër kufijsh” (me titullin në anglisht A Short border Handbook) përkthyer në gjuhën angleze, përshtatur më herët për skenë teatri në Danimarkë, Greqi dhe Kili, por ky rast “takimi” shënon herën e parë si pikë referimi dhe frymëzimi për një kompozitor me njohje botërore.

Për sa i përket Cheryl Frances-Hoad, e cila është një kompozitore shumë e veçantë (dhe e vështirë për ata që nuk kanë një edukatë solide muzikore), Kapllani thotë për “ExLibris” se nuk është në dijeni të rrethanës se si libri i ra në dorë të kompozitores britanike.

Shkrimtari tregon se në praktikën e tjera ku vepra e tij ka shërbyer, si vëniet në skenë, ka qenë në kontakt por këtë herë ishte botuesi i tij britanik që e ka njohur me linkun, shkrimin e publikuar në gazetën “The Guardian”, ku shprehet se është ndjerë i surprizuar.

“Meqë ra fjala, nëse Shqipëria do të hapet ndaj botës do ishte mirë p.sh që në Bienalen e Venecias, Shqipëria ti drejtohej Cheryl dhe ta ftonte të merrte pjesë me kompozimin e saj në Bienale. Do ishte një reklamë e madhe për Shqipërinë dhe letërsinë shqipe (dhe për librat e mi sigurisht) Thjesht një ide. Në ccdo rast unë pres të bëhet publike melodia dhe shpresoj ta takoj Cherylin – ajo vjen shpesh në Amerikë – dhe do doja ta pyesja edhe unë se si i ra në dorë libri im dhe përse ju duk kaq i veçantë sa ta frymëzonte për një pjesë muzikore”, thotë Kapllani.

Nga përvojat e tjera, Kapllani na kujton se vepra e tij është realizuar në skenën greke në vitin 2013 në “një shfaqje shumë të veçantë nga Teatri i Shurdhëve (nuk e di nëse ekziston diccka e tillë në Shqipëri, Theatre

of the Deaf është termi në anglisht). Regjizor ishte Vasilis Vilaras, një djalë i ri grek shumë i talentuar”.

“Aktorët nuk dëgjojnë dhe nuk flasin. Kështu që e gjithë shfaqja ishte në gjuhën e shenjave ndërsa kishte një ekran ku shkruheshin dialogjet/fjalitë. Shfaqja ishte një sukses i madh. Gjëja me mbresëlënëse ishte fakti se shumë prej aktorëve ishin emigrantë shqiptarë (shumica e të cilëve, për shkak të invaliditetit të tyre, janë në një institucion për shurdhë-memecë). Për mua ishte shfaqja më prekëse”, kujton shkrimtari i “Ditarit...”. Më pas libri është realizuar edhe për skenën e Teatrit Bornholm në Danimarkë në vitin 2013 (një nga teatrot më vjetër të Danimarkës). “Regjia dhe përshtatja u bë nga drejtori i teatrit Jens Svane Boutrup. Ishte një one-man shoë me aktorin danez me origjinë Kiliane, Ernesto Piga Carbone (është djali i themeluesit të Tatrit Eksperimental në Kili)”. Më pas shfaqja nga Danimarka kaloi në Kili dhe Bolivi si dhe në festival teatri në ato vende. Ka qenë aktori Ernesto Piga Carbone në Kili dhe Bolivi i cili interpretoi tekstin në spanjisht me titullin “Sindrome de Frontera” (Sindromi i Kufirit).

“Ditar i shkurtër kufinjsh”, pse u shkrua? Në një intervistë shkrimtari për arsyet e shkrimit të libri, që ka marrë aq shumë jehonë, thotë: “U shkruajt për një mijë arsye. Po tregoj më mirë mënyrën se si u shkruajt. Unë jetoja në Greqi prej katërmëdhjetë vjetësh atëherë, isha bërë shumë i njohur falë artikujve në gazetën greke “TA NEA”. Një ditë një shtëpi e rëndësishme botuese greke (“Livani”) më propozoi të shkruaj një libër me ese për ta. E vërteta është se u ula për të shkruajtur një libër me ese të titulluar “sindromi i kufijve” – një term që sajova pasi lexova një libër të Rishard Kapucinkit, gazetarit brilant Polak, “Udhëtime me Herodotin”. Në fillim të librit ai flet për tmerrin dhe magjinë që ndjeu si adoleshent kur u gjend pranë kufirit Polako-Gjerman. Ishte koha e Stalinit dhe kufiri ishte i



pakalueshëm, me tela me gjemba, me tokën e vdekur, me ushtarë dhe qen kufiri. Pak a shumë si kufiri ynë në komunizëm. Kapucinski thotë se falë atij takimi me ata kufij të frikshëm dhe absurdë ai përfitoi një lloj urie psikologjike për të udhëtuar sa më shumë, për të kaluar sa më shumë kufij. Dhe ashtu ndodhi në të vërtetë. Kapushinski udhëtoi në gjithë botën. Shkruajti libra për Afrikën, Amerikën Latine, Azinë – po pothuajse asgjë për vendin e tij, Poloninë. Tek përshkrimi i Kapucinksit unë pashë vehtën, pashë brezin tim të rritur në Shqipëri, me kufij që na kishin mbyllur brenda si në burg. Pashë edhe Ballkanasin që jeton përherë me makthin dhe fantazmën e kufijve. Pashë edhe Europeanin – sepse nuk mund ta kuptosh historinë e Europës në shekullin e XX pa kuptuar historinë e kufijve të saj. Për të gjitha këto arsye fillova të shkruaj një ese për marrëdhënien time personale me kufijnjtë. Por pas një jave i mbyllur në dhomë, duke shkruajtur ditë e natë, vura re se eseja po shndërrohej në roman, se personazhe reale dhe imagjinare kishin populluar mendjen time. Kështu libri përfundoi në roman dhe ishte pagëzimi im si shkrimtar. Është një kufi, ai i të qenit shkrimtar, që po e kalove nuk kthehesh dot më pas”.

Libri i dytë i Gazmend Kapllanit, “Më quajnë Europë” (i pabotuar ende në Shqipëri; botuar në Greqi dhe Francë) ka tërhequr, po ashtu, vëmendjen e drejtorëve të teatrit dhe artistëve moderne. Kështu në Francë aktori dhe regjizori Francez Airy Routier organizoi në vitin 2016 një atelier për aktorë dhe regjizorë të mbështetur kryekeput në tekstin e romanit të dytë të Kapllanit “Më quajnë Europë”. Artistja Bouchra Khalili e cila është e njohur për video-artet e saj, në vitin 2017 paraqiti në ekspozitën shumë të njohur Dokumenta 2017 (që u zhvillua në Athinë) një video/film titulluar “The Tempest Society”, e frymëzuar nga libri i dytë i Kapllanit, “Më quajnë Europë”. “Meqenëse libri është gjysëm fikson gjysëm realitet (rrëfimi imagjinari i një shqiptaro-greku kombinohet me historitë e vërteta të emigrantëve dhe refugjatëve nga gjithë bota që kanë kaluar kufijtë e Europës) Khalili shkoi në Athinë dhe gjeti disa nga personazhet reale të librit duke i vënë ata në skenë, paralelisht me pjesë të librit. “Imigrimi është gjithashtu në menunë në ASFA, më e dukshme në dy vepra video: Filmi 60-minutësh francez-maroken Bouchra Khalili ‘Shoqëria Tempest’ dhe filmi 20-minutësh polak Artur Zmijewski “Glimpse”. I pari, prezanton tre athinas me prejardhje të ndryshme dhe kulturat, të cilët analizojnë situatën në Greqi dhe më gjerë. Ndër çështjet e përqendruara janë trajtimi i padrejtë i emigrantëve dhe studentëve imigrantë, Referendumi Grek i Bailout, dhe rëndësia e shkrimeve të shqipes Gazmend Kapllani (përkatësisht libri i tij “Emri im është Evropa” në këtë rast), si një zë që ka shprehur shqetësimet dhe kushtet në përgjithësi të emigrantëve në Greqi», ka shkruar kritika për prezantimin e autorit shqiptar në ASFA.

V.M

PROLOG

KUFIJTË NUK I ADHUROJ. Që të jemi sinqertë, as nuk i përcmoj. Thjesht i kam frikë dhe ndjehem keq kur gjendem fillikat me ta. E kam fjalën, kryesisht, për kufijtë e dukshëm, gjeografikë, ata që ndajnë nga njëri-tjetri vendet, shtetet, kombësitë. Akoma edhe sot, në një botë ku kufijtë po bëhen gjithmonë e më shumë porozë, kuri kaloj më kaplon një ndjenjë e çuditshme: një përzierje çlirimi dhe ndrojtjeje. Kjo ndodh ndoshta për shkak të pasaportës që mbart me vete. Sidoqoftë, jam mësuar tashmë që kufijtë të më shohin me dyshim. Unë i shoh ata me përvëlim, me padurim që të kaloj në anën tjetër, kurse ata më vështrojnë thuajse gjithmonë me armiqësi ose me përçmim. Unë mundohem t’i marr me të mirë, t’i bind se nuk rrezikojnë prej meje, por ata sajojnë gjithmonë ndonjë pretekst për të më përzënë ose për t’iu shmangur një marrëdhënieje të barabartë me mua. Për të gjitha këto arsye, nuk e kam të

vështirë të them se, prej shumë kohësh, vuaj nga sindroma e kufijve. S’është e lehtë t’ju shpjegoj me saktësi se çfarë është kjo lloj sëmundjeje. Ajo s’ekziston në listën e shqetësimeve të njohura psikologjike siç janë për shembull frika e turmës, frika e lartësisë ose depresioninervor. Mund t’ju jap një ide për simptomat që e shoqërojnë, por jo tani, pak më vonë. Sidoqoftë di se ekzistojnë edhe shumë e shumë të tjerë që vuajnë nga sindroma e kufijve. Ata që nuk u përvëluan kurrë nga dëshira për të kaluar kufijtë apo nuk janë ndjerë të refuzuar nga ndonjë kufi do t’a kenë vështirë të na kuptojnë...

Marrëdhënia ime e ndërlikuar me kufijtë fillon prej qemoti. Prej fëmijërisë. Sepse, nëse do vuash apo jo nga sindroma e kufijve, është më shumë çështje fati: varet se ku do lindësh.

Unë linda në Shqipëri.

*“Ditar i Shkurtër Kufijsh”, botim Neraida.
Përkthyer nga greqishtja në shqip,
me bashkëpunimin tim, Aida Karaxha*

Gjeni me fytyrë engjëlli, adoleshent zhelan, burri me taban ere ka ushqyer revoltën e Jean Genet-it e të Jim Morrison-it. Gjenerata të shumta rebelësh kanë ecur në hapat e tij. Ndërmjet shndërrimeve të tyre: Raymond Radiguet, Françoise Sagan... dhe e pandreqshmja Minou Drouet

GJENITË ME FYTYRË ËNGJËLLI

nga Michèle Gazier

Iparakohshëm dhe i ditur si Jezusi duke folur për teologji me doktorët, djallëzor dhe i ëmbël si Kupidoni, Arthur Rimbaud me fytyrë engjëlli, me profilin e fëmijës, me fatin njëkohësisht shkëlqimtar e të zi, mishëron mrekullisht mitin e engjëllit të rrëzuar. Parakohshmëria e Rimbaud-së është shtylla e parë mbi ku ndërtohet miti në të cilin ai është në të njëjtën kohë heroi dhe viktimë. Parakohshmëri po aq shkrepimtare sa poeti vetëvritet në moshën nëntëmbëdhjetëvjeçare dhe vdes pak ditë mbas ditëlindjes së tridhjetëshe. Para kësaj vdekjeje, ai zgjedh qetësinë e brendshme, dy mënyra për t'u zhdukur që nuk kanë reshtur kurrë së ushqyeri polemikën e ndezur, imagjinatat.


Ka mes gjenisë dhe vdekjes lidhje të çuditshme e të frikshme. Gjenitë e vjetër nuk janë të numërt, madje nuk kanë, në sy të morive të turmave, popullaritetin e këtyre që kanë pasur fatin e madh ta marrin shumë herët nderimin e tyre. Simbolikisht, Rimbaud ka vdekur më pak se njëzet vjeç. Ç'do të ishte bërë me të nëse, si Hygoi, do t'i kishte shtuar gjashtë dekada proze e vargjeve veprës së vet?

Ta pret mendja, nuk mund të gjykojmë për jetëgjatësinë e njerëzve të shekullit XIX nën përmasën e të vetmit Hygo. Asokohe vdisje i ri dhe dyzetvjeçar nuk ishte larg një plaku. Megjithatë, në shekullin e Rimbaud-së, disa dekada para tij, janë të tjerë shkrimtarë të mëdhenj e dijetarë të shuar në kulmin e artit të tyre e në ag të moshës së të rriturit: poeti

gjerman Georg Büchner, autor i *Woyzeck*, ishte njëzet e katër vjeç kur u largua prej kësaj bote; Mikhaël Lermontov, të cilit i detyrohemi romanin shumë të bukur *Një hero i kohës tonë*, ishte njëzet e pesë vjeç. Për sa i përket matematikanit Évariste Galois, në moshën njëzetënjëvjeçare që zhduket, i goditur për vdekje në një duel; Isidore Ducasse, i ashtuquajtur Comte de Lautréamont, bashkëkohësi i rreptë i Rembaud-së e autor i të famshmeve *Këngë të Maldadorit*, e ka lënë këtë botë më 1870, në moshën njëzetekatërvjeçare, duke lënë mbas vetes një vepër të mistershme, të çmendur, profetike, që shkrimtarë, psikanalistë e kritikë nuk reshtin së zbuluari. Një zë thyhet, por kënga e tij më shumë se kurrë mbetet.

Në rininë mitike të Rimbaud-së, që mbetet për lexuesit e vet përjetshëm adoleshent e bashkëfajtor, shtohet aureola e horrit, i të dorës së dytë, djaloshtit endacak me flokë të pakrehur, "grushtet në xhepa të shpuar", vagabond e bohem. E përfytyrojmë "burrin me taban ere" duke i rënë kryq e tërthor Europës së murgullt, pijetoreve me nam të keq, alkoolin trimonedhash që të djeg fytyrën, djemtë që u qepen femrave, drogën, vetminë, kërkimin e dashurisë, miqësisë, hedhjen tek tjetri – fatkeqi Verlaine të mahnitur – që ju do shumë, shumë keq, që të ngjitet, që vdes prej dëshpërimit, prej xhelozisë...

"Nuk kam qenë kurrë prej këtij populli; nuk kam qenë kurrë i krishterë; jam prej racës që këndonte




në sflitje; nuk i kuptoj ligjet; nuk zotëroj kuptim të moralshëm, jam një i pagdhendur", - shkruante ai te *Një stinë në ferr*. Ai që "ende krejt fëmijë, do të adhuronte të burgosurin e paarsyeshëm i cili kyçet gjithmonë në burg", ruan mbyllët kepin e rrugëtarit drejt qyteteve të ndriçuara që do ta bënin ta harrojë jetën e ngushtë që nuk resht së arratisuri.

Dukshmëria që ne do ta quajmë romantike e këtyre viteve të dhimbshme endjesh e shkrimi, që do të zgjasin për kohë të gjatë mbasi ai pati mohuar dehjen prej fjalëve, me udhëtime të largëta e gjeste tregtish të dyshimta e të dështuara në Perëndim, ka molepsur shkrimtarë e artistë. Në radhën e tyre ata kanë ëndërruar ose e kanë ëndërruar për veten e tyre, për gjeninë Rimbaud. Pse jo ata që kishin moshën e tij, sjelljet e tij, shijet e tij artistike a seksuale, shqetësimin e tij e ndonjëherë madje diçka prej sharmit të tij fizik.

Diabolikët

Me më shumë apo më pak talent, më shumë apo më pak natyrshmëri, Rimbaud-të e rinj kanë lulëzuar në letërsi. Për ta filluar me Raymond Radiguet-in. Njëzetvjeçar, fizik i gjatë, shije e vërtetë e magjepsjes, mbrojtës i fuqishëm e besnik – Jean Cocteau – dhe një pendë e hollë. "Digjesha flakë, thekja hapin, si njerëzit që duhet të vdesin të rinj e që i grahen punës", - shkruante ai te *Djali në trup* në një lloj vetëportreti të lumtur e të dëshpëruar.

Prej kësaj vdekjeje të rrufeshme, Cocteau do ta kishte shumë të vështirë ta marrë veten dhe do ta kalojë pjesën e mbetur të jetës duke kërkuar për Radiguet-Rimbaud-të me taban zjarri. Por nuk do të gabohet me gjeninë e re të parakohshme të zbuluar më 1955 nga botuesi i tij, René Julliard, një vajzë e vogël me shikim lehtësisht dyshues, me çehre të padjallëzuar, që shkruante vargje. Përballë kësaj çapëneje të pafajshme, Cocteau thotë me zë të lartë: "Të gjithë fëmijët nëntëvjeçarë janë gjeni, përveç Minou Drouet-it." Siç shkruan Roland Barthes në kapitullin e *Mitologjive* kushtuar poeteshës së re: "Sot, gjeni do të thotë të fitosh kohë, është të bësh në moshën tetëvjeçare çka ne e bëjmë normalisht në moshën 25 vjeç. [...] Flitet për të ecur pak më shpejt se të gjithë njerëzit. Fëmijëria do të bëhet, pra, vendi i privilegjuar i gjenisë." Për fat, ky tip gjeniu nuk ka lënë shumë gjurmë. Shkëndija e saj nuk ishte e tillë sa të ketë ndriçuar një rrym.





Martir

Në një gjini tjetër, e gjithmonë tek i njëjti botues René Julliard, një vajzë e re nëntëmbëdhjetëvjeçare, Françoise Sagan, bën skandal në shkurrajën e letrave me një roman të parë, *Mirëdita trishtim*, që do të jetë njëri prej bestsellerëve më të mëdhenjve të shekullit. Ajo është provinciale, e lindur në Lot. Shkruan si t'i vijë, me paturpësi, duke ndërmarrë rreziqe, duke mos pasur frikë t'i djegë krahët as për t'i luftuar tabutë e një borgjezie që ajo e pikturon me vitriol.

Shkurt, Sagan jep ca shkelma në thneglën e romanit social e psikologjik. Muzika e saj e vogël ngazëllon, nuk pëlqen, intereson. Sido qofshim, të tronditur a të fituar, lexojmë Sagan. Vajza e re që ndien netët e bardha e lidhjet e rrezikshme, është e prekur nga mbrojtja e engjëllit dhe e fshikur nga krahuri i djallit. Hija e Rimbaud-së rri pezull. Por ajo e ka jetën të ngjitur mbas trupit. Dhe, sado e brishtë, i tejkalon dekadat... Në mënyrën e vet, Sagan gjithashtu bëhet një mit. Qysh prej një gjysmë shekulli, botimi është në kërkim të një Sagani të re.

Në gjurmën e Rimbaud-së, shumë i afërt me të për nga vështirësia se nga parakohshmëria letrare, Jean

Genet. Fëmijë i përbuzur, i braktisur nga nëna, nuk e njohu kurrë të atin. I ngulur në asistencën publike, edukohet prej ca fshatarëve nga Morvani. Një ditë akuzohet për vjedhje. Shkruan në *Ditar Hajni*: "Për t'i mbijetuar dëshpërimit, kur sjellja ime ishte më shumë e ndrydhur, përpunoja pa shpërblim një disiplinë të rrezikshme. [...] Për çdo akuzë të sjellë kundër meje, qoftë ajo e padrejtë, prej thellësisë së zemrës do të përgjigjesha po. Me zor e shqiptoja këtë fjalë. [...] thellë ndieja nevojën për t'u bërë ajo çka ata më kishin akuzuar se isha. Isha gjashtëmbëdhjetë vjeç." Dihet vazhdimi, shtëpi riedukimi, arrati, vjedhje, prostituim, vagabondim, vjedhje, burg... mandej shkrimi vjen si një shëlbim për ta shpëtuar horrin. Në parathënien e pesëqind e shtatëdhjetë e katër faqeve që i kushton Genet-it nën titullin *Shenjtori Genet, komedian e martir*, Sartri shkruan sa i përket këtij akuzimi të parë për vjedhje, të cilit Genet-i do t'ia ruajë përgjithmonë gjurmën: "Një fëmijë vdes nga turpi, mbin në vend të tij një rrugaç; rrugaçi do të xhindoset nga fëmija." Bashkëbisedim i frytshëm mes të dyve që bën të lulëzojë kështu një vepër shëlbuese. Në të kundërt të Rimbaud-së, Genet-i do të shpëtohet me anën e të shkruarit.

“

Në gjurmën e Rimbaud-së, shumë i afërt me të për nga vështirësia se nga parakohshmëria letrare, Jean Genet. Fëmijë i përbuzur, i braktisur nga nëna, nuk e njohu kurrë të atin. I ngulur në asistencën publike, edukohet prej ca fshatarëve nga Morvani.

Në rrugë

Vepra e Rimbaud-së është si një lëkurë e çmuar që është krijuar në vuajtje dhe që ai e ka braktisur mbas vetes. Për poetin e Charleville-s si për këtë gjenium tjetër fatkeq siç qe Moxart-i, zulma e pasvdekjes, krijimi i një miti, por pa shpëtim. Është pa dyshim ky fat i zi i Rimbaud-së, bredhja fatkeqe, lypja e pafundme e një vendi ku të ngjizet larg brengave të fëminisë, pakuptimësisë mëmësore, heshtjes së të atit, budallallëkut e mendjengushtësisë njerëzore që kanë frymëzuar shkrimtarët e brezit të Beat-it që përfaqësohen prej tij. Jehona e *Një stinë në ferr* tringëllon në revoltën e tyre: Jam i armatosur kundër drejtësisë.

*Ia kam mbathur. O magjistarë, o mjerime,
o urrejtje, ju që thesari im u qe besuar!
Ia dal të humbë ndjenjat
në shpirtin tim e gjithë shpresa njerëzore.
Mbi çdo gëzim për ta mbytur linda
kërcimin e shurdhët të kafshës së egër.*

Indyrë

Bert Mathieu, mik i ngushtë i Henry Miller-it e Allen Ginsberg-ut, profesor i vjetër në Universitetin e Yale-s, autor i një veprë mbi Rimbaud e Miller dhe përkthyes i veprës së Rimbaud-së, pohon që është Jack Kerouac që ia ka bërë të njohur Rimbaud-në Ginsbergut më 1944. Shkrimtarë të rrugës, revoltës, kundër një shoqërie të kalbur e shterpë, Kerouac, Ginsberg dhe në hapat e tyre këngëtarë, si Bob Dylan, Rolling Stones, Lou Reed e në veçanti Jim Morrison, zëri i Doors-ave, e kanë vënë Rimbaud-në në tekstet e jetën e tyre. Sipas Bert Mathieu, Mick Jagger e dinte Rimbaud-në përmendësh dhe Jim Morrison do të kishte bërë pelegrinazh në Charleville. Por përtej anekdotës, këtij ripërvetësimi të përhershëm të ikonës e të dhunës së poetit të Ardenëve, nuk mundesh të jesh përveçse i kamufluar prej modernitetit të një veprë që, ngaqë është pa vend e pa epokë, sfidon kohën.

Por ç'do të kishte ndodhur me Rimbaud-në nëse fytyra e tij prej engjëlli nuk do të kishte shoqëruar vrullin e adoleshentit, gjeninë e tij të halabakut e bredhjen e tij të fëmijës së humbur? Engjëlli dhe horri. Skëterra e ferrit dhe ndriçimet e fjalëve. "Jam e ndyrë si Rimbaud", - këndon Brigitte Fontaine në një këngë të mrekullueshme e pa mesazh. "Jam i bukur si Rimbaud", - sugjeronte Jim Morrison mes shkëlqimeve të skenës e purgatorëve të parajsave të tij artificiale. Njëqind vjet më vonë, Rimbaud na rizgjon sërish. Në fillim të udhëtimit, na thotë ai, është përsëri deti, tresoja e fjalëve e vrujimi i dëshirës:

*Por, vërtet, shumë kam qarë! Agimet janë pikëllonjëse.
Çdo hënë është mizore e çdo qiell hidhët:
Dashuri helmët më ka mbufatë limontitë debëse.
Ah sikur kallumca ime të vezullojë! Ah sikur të përfundojë
në det!*

Marrë nga *Telarama hors serie*, kushtuar Arthur Rimbaud në 150-vjetorin e lindjes.
Përktheu: Anila Xhekaliu

Çmimi Nobel 1949

W. FAULKNER

duke dhënë shpirt



OnufriRoman

Stanhope A. Forbes
1921